EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5884
E shtunë, 21 shtator 2019
çmimi 0.40 €

Veseli: Plani Kundër Korrupsionit do të krijojë kushte më të favorshme për bizneset

FAQE 9

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", LUTFI HAZIRI

VJOSA OSMANI MË 6 TETOR DO TË BËHET ZONJA E SHTËPISË

FAQE 4-5

Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, ka thënë se qytetarët po e mirëpresin dhe po i besojnë ofertës së kësaj partie për zgjedhjet e 6 tetorit. Ai ka thënë se programi i LDK-së është për një Kosovë më të mirë, më demokratike dhe më të zhvilluar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Haziri ka deklaruar se nga 6 tetori Vjosa Osmani do të bëhet zonja e shtetit të Kosovës. Ai ka thënë se fitorja e LDK-së që do të ndodhë në këto zgjedhje u atribuohet qytetarëve të Kosovës. Sipas Hazirit, qeverisja e LDK-së, përveç zhvillimit ekonomik dhe sundimit të ligjit, do t'i relaksojë marrëdhëniet me miqtë ndërkombëtarë. Kurse sa i përket dialogut me Serbinë, ai ka thënë se kryeministrja e ardhshme ka platformën e gatshme dhe në Kuvend do të ndërtohet konsensusi në nivel kombëtar

Limaj: Kosovës i duhet një qeveri reformatore

FAQE 7

Dreshaj: Vetëm me Haradinajn kryeministër realizohet koncepti 100 për qind shtet

Kandidati për deputet i koalicionit AAK-PSD, Gani Dreshaj, në një bisedë për gazetën "Epoka e re", ka thënë se vetëm me Ramush Haradinajn kryeministër mund të realizohet koncepti 100 për qind shtet. Ai ka thënë se më 6 tetor koalicioni AAK-PSD do të dalë fitues i zgjedhjeve. Dreshaj ka treguar se në listën për deputetë ka hyrë për interes të vendit dhe jo për të përfituar diçka për vete pasi, sipas tij, ai nuk ka nevojë për një pagë të deputetit FAQE 3

OPINION

BISEDIMET ME SERBINË PËRCAKTOJNË KOALICIONET PAS ZGJEDHJEVE DHE QEVERINË E RE E JO REZULTATI I ZGJEDHJEVE F. 10-11

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

CILA PARTI POLITIKE GUXON TA ZGJIDHË PROBLEMIN E KADASTRËS? F. 11

Shkruan: Dr. sc. Përparim AMETI

AKTUALE

NËNSHKRUHET LISTA E RE E BARNAVE ESENCIALE F. 2

EKONOMI

DEFICITI TREGTAR I KOSOVËS KALON MBI TRE MILIARDË EURO F. 9

KULTURË

NXËNËSIT E AKRASHTICËS SË VUSHTRRISË BOTOJNË LIBËR ME POEZI F. 11

SPORT

DABIQAJ: FERONIKELI SHPEJT DO TË JETË ATY KU E KA VENDIN F. 18

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Ambasadori i ri i Izraelit, i paraqet letrat kredenciale presidentit Meta

TIRANË, 20 SHTATOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta priti të premten në një takim ambasadorin e ri të Izraelit në Shqipëri, Noah Gal Gedler, me rastin e paraqitjes së letrave kredenciale.

Presidenti Meta e uroi ambasadorin Gedler për marrjen e detyrës dhe i përcolli përshëndetjet dhe falënderimet për presidentin Reuven Rivlin dhe autoritetet izraelite për emërimin në Tiranë të një diplomati me eksperiencë dhe kontribut të shquar në këtë fushë.

Kryetari i Shtetit e siguroi ambasadorin Gedler për bashkëpunim të ngushtë me qëllim forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore e historike ndërmjet Izraelit dhe Shqipërisë dhe dy popujve tanë.

Duke vlerësuar marrëdhëniet shumë të mira ndërmjet dy vendeve, si dhe trendin pozitiv të bashkëpunimit ekonomik, presidenti Meta theksoi se ka ende potencial për t'i rritur më tej marrëdhëniet ekonomike-tregtare.

"Izraeli mund të shërbejë si një shembull i shkëlqyer se si një komb i vogël, që përballet me shumë sfida, mund të zhvillojë vendin e tij, mbështetur në kapacitetin njerëzor e intelektual. Jam krenar, për kontributin e shqiptarëve në shpëtimin e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore", u shpreh presidenti Meta.

Me këtë rast, Kreu i Shtetit konfirmoi pjesëmarrjen në Konferencën Botërore për Holokaustin, që do të zhvillohet në janar 2020 në Jerusalem, i ftuar nga presidenti i Izraelit Reuven Rivlin.

ShBA dhe Britania e Madhe: Zhgënjim dhe pikëpyetje për gjyqin e Tahirit

Në reagimin e Ambasadës amerikane thuhet se ndërkohë që dënimi i Tahirit për akuzën e shpërdorimit të detyrës sinjalizon një hap të rëndësishëm përpara, dënimi është shkurajues, duke pasur parasysh se sa të rënda ishin akuzat dhe se ata që shpërdorojnë besimin publik dhe shkelin ligjin duhet të përballen me pasoja domethënëse

TIRANË, 20 SHTATOR - Dënimi i Saimir Tahirit vetëm me 3 vjet shërbim provë dhe rrëzimi i akuzave për trafik droge dhe organizatë kriminale ka sjellë reagime të forta nga ambasadat kryesore në vend.

Ambasada amerikane, pasi thotë disa fjalë pozitive për pavarësinë e gjyqësorit, nuk e fsheh zhgënjimin për vendimin e shkallës së parë të Gjykatës për Krime të Rënda. ShBA-ja thotë se vendimi tregon pavarësi në rritje të gjyqësorit, por është shkurajues duke pasur parasysh akuzat e rënda në ngarkim të Saimirit Tahirit.

"Vendimi i djeshëm kundër ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri demonstron pavarësinë në rritje të gjyqësorit dhe fillimin e fundit të pandëshkueshmërisë për personat me lidhje të forta. Ndërkohë që dënimi i Tahirit për akuzën e shpërdorimit të detyrës sinjalizon një hap të rëndësishëm përpara, dënimi është shkurajues, duke pasur parasysh se sa të rënda ishin akuzat. Ata që shpërdorojnë besimin publik dhe shkelin ligjin duhet të përballen me pasoja domethënëse. Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë të mbeten partnerë të Shqipërisë, në mbështetje të përparimit të mëtejshëm të reformës në drejtësi, transparencës dhe qeverisjes së mirë", thuhet në reagimin e Ambasadës së ShBA-së.

Një reagim edhe më të ashpër ka bërë ambasadori i Britanisë së Madhe në Tiranë. Në një komunikim me gazetarët, ambasadori Norman Duncan tha se vendimi për Saimir Tahirin ngre pikëpyetje.

"Verdikti për Saimir Tahirin tregon se sistemi gjyqësor në Shqipëri po maturohet. Por dështimi për të dhënë dënim për akuza me të rënda ngre pikëpyetje dhe tregon rëndësinë për ta çuar deri në fund reformën gjyqësore në vend", thuhet në reagimin e Ambasadës së Britanisë së Madhe.

Gjykata e Krimeve të Rënda në Shqipëri e ka shpallur fajtor ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri për shpërdorim detyre, por nuk e gjeti fajtor për akuzat e trafikut të drogës.

Si pasojë, gjykata e dënoi ish-ministrin Tahiri me 5 vjet burgim, por duke qenë se ai më parë kishte pranuar gjykimin e shkurtuar, atëherë dënimi sipas vendimit, konvertohet në 3 vjet e 4 muaj shërbim prove, e kjo do të thotë se Tahiri nuk do të burgoset.

Franca, e pavendosur për dhënien e datës për Shkupin

SHKUP, 20 SHTATOR - Franca mbetet e pavendosur për miratimin e datës për Maqedoninë e Veriut për fillimin e negociatave të anëtarësimit në BE. Ambasadori Francës në Shkup Kristian Timonie, deklaroi se vendi i tij vlerëson reformat e bëra në vend por thekson se standardet e këtij vendi duhet të përkojnë me standardet evropiane.

"Jemi duke reflektuar. Këto reflektime kanë qenë të ndihmuara edhe nga vizitat rishtazi të ministrit të Jashtëm Nikolla Dimitrov në Paris. Autoritetet franceze kanë ndarë vlerësimet e tyre të larta për Marrëveshjen e Prespës, njëkohësisht kanë vlerësuar edhe reformat që po bëhen. Ata kanë këmbëngulur vazhdimisht për konsolidimin e shtetit të së drejtës, njëkohësisht kanë përsëritur qëndrimin e presidentit Makron për Ballkanin Perëndimor. Cilido qoftë vendimi që do të merret me vendet e tjera anëtare, këtu duhet të mbizotërojë stabiliteti dhe njëkohësisht prosperimi dhe zhvillimi. E di se ajo që ju kërkoni është data, por njëkohësisht duhet që standardet e këtij vendi të përkojnë me standardet evropiane", pohoi Kristian Timonie, ambasador i Francës.

Ndërkohë, zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane Bujar Osmani ka vazhduar turneun e vizitave të tij në kryeqytetet e vendeve anëtare të BE-së për t'i bindur ata se Shkupi meriton datë. Në Varshavë të Polonisë, Osmani ka marrë mbështetje nga ministri i Jashtëm polak dhe sekretari shtetëror në Ministrinë e Jashtme.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Dreshaj: Vetëm me Haradinajn kryeministër realizohet koncepti 100 për qind shtet

Kandidati për deputet i koalicionit AAK-PSD, Gani Dreshaj, në një bisedë për gazetën "Epoka e re", ka thënë se vetëm me Ramush Haradinajn kryeministër mund të realizohet koncepti 100 për qind shtet. Ai ka thënë se më 6 tetor koalicioni AAK-PSD do të dalë fitues i zgjedhjeve. Dreshaj ka treguar se në listën për deputetë ka hyrë për interes të vendit dhe jo për të përfituar diçka për vete pasi, sipas tij, ai nuk ka nevojë për një pagë të deputetit

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Kandidati për deputet i koalicionit AAK-PSD, Gani Dreshaj, ka treguar arsyen pse ka vendosur që edhe në zgjedhjet e 6 qershorit të jetë në listën për deputetë. Ai në një bisedë për gazetën "Epoka e re", ka theksuar se në listën për deputetë ka hyrë për interes të vendit dhe jo për të përfituar diçka për vete pasi, sipas tij, ai nuk ka nevojë për një pagë të deputetit. "Kam hyrë në listë për interes të vendit dhe jo për interesin personal. Qëllimi im është që nga ulësja e deputetit të shtyjë përpara ndonjë projekt për qytetarët e komunës sime, Istogut dhe qytetarëve në komunat e tjera. Pra, garimi im si deputet nuk ka qëllim që të jem aty për të siguruar një pagë, apo asnjë të ardhur financiare, por që i jam përgjigjur pozitivisht besimit të Këshillit të Përgjithshëm të AAK-së për të cilin jam mirënjohës dhe do të bëjë gjithçka që ta arsyetojë këtë besim", ka thënë Dreshaj.

Ai ka treguar se në listën e koalicionit AAK-PSD mban numrin 40. Dreshaj ka thënë se si deputet, sikurse në mandatin e kaluar, do të angazhohet që të punojë pa hile, me nder dhe dinjitet. Ai ka thënë se projekti i AAK-së dhe partnerit të tyre PSD-së 100 për qind shtet siguron stabilitet për të ardhmen e qytetarëve dhe vetë shtetit të Kosovës.

Ish-deputeti Dreshaj ka thënë se në këto zgjedhje AAK-ja ka hyrë shumë e përgatitur, për faktin se ka një arsye për t'u dalë përball qytetarëve. Ai thotë se Haradinaj ishte kryeministri i vetëm që mundi t'i shtyjë përpara vendimet e mëdha. "Kosova i ka njerëzit e shtëpisë që janë dëshmuar në mbrojtje të pragut të saj, në këtë rast z. Haradinaj si kryeministër mori vendim për ta krijuar ushtrinë, doli në mbrojtje të Trepçës, vendosi taksën me Serbinë, i tha jo ndarjes së Kosovës dhe në këtë pikë qëndroj i vetëm. Gjithashtu, bëri Ligjin për Prishtinën. Të gjitha këto e shumë të tjera u bënë në Qeverinë Haradinaj. Vetëm me Ramush Haradinaj kryeministër mund të realizohet koncepti 100 për qind shtet", ka thënë Dreshaj.

Ai thotë se, sipas sondazheve të fundit, koalicioni AAK-PSD po konkurron për vendin e parë. "Si koalicion jemi në garën për vendin e parë. Më 6 tetor do të konfirmohet fitorja e koalicionit AAK-PSD me kryeministër Haradinaj", ka deklaruar Dreshaj.

Ai ka shtuar se koalicioni AAK-PSD ka listën më të mirë për deputetë. "Ky koalicion ka emra profesionistësh për deputetë nga lëmenj të ndryshëm. Lista jonë është më e mira", ka pohuar Dreshaj.

I pyetur rreth koalicioneve të mundshme pas zgjedhjeve nëse koalicioni AAK-PSD del fitues, Dreshaj ka thënë se AAK-ja është parti e hapur për krijimin e qeverisë së re por, sipas tij, pas 6 tetorit si parti fituese do të shohin më saktësisht se me kë do të bëjnë koalicion për krijimin e qeverisë së re. "Pas 6 tetorit ne jemi të parët dhe jemi të hapur për krijimin e qeverisë së re. Normalisht shikohen edhe programet dhe relacionet se me cilat parti AAK-ja ka bashkëpunim më të mirë sepse vendin e presin procese të rëndësishme", ka thënë Dreshaj.

Nënshkruhet lista e re e barnave esenciale

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka nënshkruar të premten listën e re të barnave esenciale të Kosovës e cila synon që qytetarëve të vendit t'u sigurojë barna cilësore, të sigurta dhe të përballueshme. Ai ka thënë se deri te ky rezultat është arritur pas një procesi të gjatë, përkushtimi të madh të ministrisë dhe komitetit teknik për hartimin e saj dhe një punë profesionale e transparente. "Në fillim të mandatit tim si ministër kur e kam kuptuar se kjo listë nuk është përditësuar që nga viti 2012, e kam vënë menjëherë si prioritet revidimin e saj, i bindur se mungesa e përditësimit të një dokumenti kaq të rëndësishëm është një barrë e rëndë për sektorin e shëndetësisë, shëndetin, ekonominë dhe mirëqenien e

qytetarëve tanë. Sot me nënshkrimin e kësaj liste ne po u dalim në ballë përgjegjësive tona institucionale dhe pas një kohe të gjatë po krijojmë një mburojë financiare të mirëfilltë për popullatën tonë", ka thënë ministri Ismaili. Ai ka shprehur një falënderim për komitetin teknik për punën njëvjeçare në listë dhe për Zyrën Qendrore të OBSh-së në Gjenevë dhe atë në Prishtinë, për përkrahjen në hartimin e kësaj liste, e cila tash e tutje do të përditësohet sipas praktikave që i ka kjo organizatë.

Ministri Ismaili ka pohuar se revidimi i LBE, bashkë me miratimin e UA për rregullimin e çmimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore, paraqesin, në fakt, thelbin e zhvillimit të reformës në sektorin farmaceutik në Kosovë.

Në ceremoninë e nënshkrimit të Listës së Barnave Esenciale ishte i pranishëm edhe kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, i cili e konsideroi si të arritur shumë të madhe miratimin e kësaj liste, duke vlerësuar se në shëndetësi po bëhet kthesë vendimtare.

Flet për "Epokën e re", Lutfi Haziri

Vjosa Osmani më 6 tetor do

Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, ka thënë se qytetarët po e mirëpresin dhe po i besojnë ofertës së kësaj partie për zgjedhjet e 6 tetorit. Ai ka thënë se programi i LDK-së është për një Kosovë më të mirë, më demokratike dhe më të zhvilluar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Haziri ka deklaruar se nga 6 tetori Vjosa Osmani do të bëhet zonja e shtetit të Kosovës. Ai ka thënë se fitorja e LDK-së që do të ndodhë në këto zgjedhje u atribuohet qytetarëve të Kosovës. Sipas Hazirit, qeverisja e LDK-së, përveç zhvillimit ekonomik dhe sundimit të ligjit, do t'i relaksojë marrëdhëniet me miqtë ndërkombëtarë. Kurse sa i përket dialogut me Serbinë, ai ka thënë se kryeministrja e ardhshme ka platformën e gatshme dhe në Kuvend do të ndërtohet konsensusi në nivel kombëtar

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 20 SHTATOR -

"Epoka e re": *Z. Haziri, si po pritet nga qytetarët oferta e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe kandidatja për kryeministre, Vjosa Osmani?*

Haziri: Gjatë këtyre dy javëve kemi takuar qytetarët në të gjithë territorin e Kosovës, te të cilët kemi përçuar mesazhin tonë për një Kosovë më të mirë, më të lirë, më demokratike dhe më të zhvilluar. Kosova është më keq se dje, prandaj koha për LDK-në dhe rikthimin e saj të madh po vjen. Në takimet dorë më dorë qytetarët na kanë dhënë mbështetje të plotë për ta realizuar programin tonë qeverisës dhe për t'i zgjidhur së bashku problemet. Me këtë rast, më lejoni që t'i falënderoj edhe bashkatdhetarët tanë që jetojnë kudo në botë sepse ata janë heronjtë e gjallë të Kosovës. Tendenca që mërgata të ngjyroset me ngjyra dhe ideologji të majta është e paqëndrueshme sepse ajo gjithmonë ka qenë krahu më i rëndësishëm i Kosovës. Është në vullnetin e saj të lirë për të vendosur dhe për ta shfrytëzuar të drejtën e votës duke mos lejuar të bëhet pre e ngjyrave dhe ideologjive të cilat në Kosovë kanë me shumë qëllime manipuluese sesa reale. Ka ardhur koha që nga 6 tetori në Kosovë zonjë e shtëpisë të bëhet Vjosa Osmani.

"Epoka e re": *Pse mendoni se po vjen koha për qeverisjen e LDK-së dhe cilat janë tri arsyet për të cilat duhet t'ju votojnë qytetarët?*

Haziri: Janë 134 arsye të mëdha, ndoshta edhe më shumë! Arsyeja kryesore është se Kosova ka degraduar politikisht dhe institucionalisht. Liria e saj është e cenuar nga arroganca politike, si dhe shkalla e demokracisë po rrëshqet drejt një autokracie. Edhe pavarësia e vendit nuk është e shtrirë në të gjithë territorin e Republikës dhe po rrezikohet çdo ditë nga këto sjellje. Rikthimi i madh i LDK-së si parti më e madhe dhe më e fuqishme do të konfirmohet më 6 tetor. Sundimi i ligjit, punësimi, zhvillimi dhe ekonomia e lirë janë shtyllat e programit tonë që po shpaloset çdo ditë në terren dhe po besohet nga qytetarët. Thirrja jonë për besim ka dalë nga ajo që e kemi parë në pritjen që na kanë organizuar qytetarët nëpër komuna të ndryshme të vendit.

"Epoka e re": *Mund ta kthejë qeverisja e LDK-së Kosovën në binarët e duhur si dhe t'i f inalizojë me sukses proceset e rëndësishme për të ardhmen e shtetit, meqë kundërshtarët po e quajnë LDK-në dhe znj. Osmani të pafuqishme?*

Haziri: Për fitore dhe sukses të Kosovës nuk është më pak burrni për t'u rreshtuar pas një gruaje e cila do ta garantojë realizimin e programit më të mirë qeverisës. Osmani e ka fuqinë politike, kompetencën, si dhe e ka pavarësinë e plotë në vendimmarrje. Askush nuk duhet të frikësohet, në veçanti ata që do të shkojnë në opozitë nga vendimet e drejta, të shpejta dhe të fuqishme që kryeministrja e ardhshme do t'i marrë. Tendenca për t'u fshehur mbrapa një gruaje në emër të pafuqisë është vetëm seksizëm mashkullor e assesi diçka tjetër. Por, ne e kuptojmë këtë sepse ato parti udhëhiqen nga meshkujt e fortë që i kanë duart e lidhura për shumë arsye dhe me shumë fije. Përkundrazi në LDK veprohet në ekip, edhe në qeveri do të punohet ashtu dhe ekzekutivi do ta ketë fuqinë dhe pavarësinë vendimmarrëse deri në fund.

"Epoka e re": *Madje z. Kurti në paraqitjet televizive po insiston se Vjosa do të bëhet kryeparlamentare.*

Haziri: Pa vetëdije z. Kurti e ka hequr maskën dhe ka treguar se është autokrat. Emërimet e tilla publike janë veçori të autokratëve. Ata bëjnë me gisht, emërojnë, shkarkojnë, linçojnë dhe lavdërojnë në publik kur të kenë qejf. Emërimi i kryetarit të Kuvendit, i kryeprokurorit të shtetit, shkarkimi dhe largimi i 12 deputetëve të tij, largimet dhe ofrimet që i bënë janë tregues dhe simptoma të sjelljes autokrate. Ky vend po vuan nga tendenca e autokracisë dhe nuk bën ta rrezikojmë shkallën e demokracisë parlamentare që e kemi zhvilluar në këta dhjetë vjet si shtet i pavarur. Kultura europerëndimore që e bartë Vjosa Osmani në emër të

të bëhet zonja e shtëpisë

LDK-së është kulturë e debatit, e sundimit të ligjit, e respektimit të pavarësisë së institucioneve dhe sjelljes me kompetencë karshi këtyre. Kosova nuk ka nevojë ta ndërrojë një Kadri Vesel për një Albin Kurt sepse mënyra se si sillen dhe vendosin dhe deklarohen publikisht është autokraci, është kulturë lindore e udhëheqjes së shtetit. Kosova po rrezikohet nga tendenca e kulturës lindore, por qytetarët nuk e pranojnë këtë kulturë, këtë sjellje si dhe nuk do të lejojnë që Kosova të lidhet me një nyje e cila do të jetë kërcënim për shtetin në të ardhmen.

"Epoka e re": *Këto sjellje të Kurtit e pamundësojnë një koalicion LDK-LV pas zgjedhjeve të 6 tetorit?*

Haziri: Këto janë në nivel deklarativ. Ne kemi hapur një faqe të re të bashkëpunimit parazgjedhor dhe natyrisht jemi të interesuar që në pika të cilat na bashkojnë ta lëmë mundësinë dhe derën e hapur. Nuk kam çka të them më shumë nga ajo që ka thënë lideri i LDK-së, Isa Mustafa, në ditën kur është vendosur që partitë të garojnë të vetme dhe jo si koalicion parazgjedhor. Apeli i tij dhe përkushtimi i LDK-së është se duhet të ndërtojnë shkallë partneriteti në mirëbesim të gjithë ata që e duan këtë shtet dhe ne jemi duke u sjellë konform kësaj me lojalitet. Nuk lejojmë të na atakohet dhe targetohet kandidatja për kryeministër vetëm se kanë frikë nga humbja. As lideri i PDK-së, as i LV-së dhe as liderët e tjerë nuk e kanë mbështetjen që sot e ka Vjosa Osmani dhe LDK-ja në terren. Ky masivitet dhe kjo pritje po ndërtohet në besim të plotë mes nesh dhe qytetarëve.

Suksesi dhe fitorja e LDK-së që do të ndodhë më 6 tetor iu atribuohet qytetarëve të Kosovës. Falë rikthimit të besimit të tyre në LDK dhe në ofertën e saj, kjo parti politike mbetet gardiane e republikës që është nderuar me mundin e qytetarëve të saj brenda dhe jashtë vendit, si dhe me ndihmën e miqve në krye me ShBA-në, pa të cilën nuk mund të imagjinohet e nesërmja dhe e ardhmja e Kosovës. Mirëpo në këto vitet e fundit janë tensionuar marrëdhëniet me mikun më të madh, ShBA-në, me partnerët më të mëdhenj evropianë, si dhe me aleatin më të madh ushtarak që ende është duke e ruajtur paqen në Kosovë e cila është arritur me mund, sakrificë dhe gjak. LDK-ja do të jetë siguria politike e zbatimit të ligjit. Respektojmë funksionimin e gjykatave, të prokurorisë, policisë, por do të punojmë që t'i largojmë duart e gjata të atyre që e kanë kapur shtetin me çdo kusht. Vjosa Osmani e ka lirinë e plotë që ato duar t'i shkurtojë njëherë e përgjithmonë dhe t'i nxjerrë nga thesi i madh i buxhetit të shtetit që i kanë vendosur shumë njerëz në vitet e fundit.

"Epoka e re": *Është prioritet i qeverisë suaj relaksimi i raporteve me partnerët ndërkombëtarë?*

Haziri: Gjatë kësaj kohe kemi pasur takime të rregullta pune me partnerët tanë më të mëdhenj Uashingtonin, Brukselin, Berlinin dhe qendrat kryesore politike. Miqtë tanë nuk duhet t'i përziejmë në fushatë zgjedhore sepse ata janë miq të popullit të Kosovës dhe jo të partive politike. Miqësia e popullit të Kosovës me popullin amerikan është më e shenjtë se gjithçka tjetër. Qeveria e LDK-së, e udhëhequr nga Vjosa Osmani, do ta rikthejë në mirëbesim të plotë partneritetin si dhe do t'i koordinojë të gjitha veprimet në interes të shtetit me miqtë e saj sepse ata janë mbështetësit më të mëdhenj të këtij populli.

"Epoka e re": *Z. Haziri, miqtë e Kosovës po kërkojnë që pas zgjedhjeve ta heqë taksën dhe ta vazhdojë dialogun për normalizim të raporteve me Serbinë. A do ta bëjë LDK-ja një gjë të tillë nëse i fiton zgjedhjet?*

Haziri: Dialogu edhe me Kushtetutë edhe me vendim të Gjykatës Kushtetuese i takon Qeverisë së Kosovës. Kryeministrja e ardhshme e ka platformën e gatshme dhe Kuvendi i Kosovës është organi ku do të ndërtohet konsensusi. LDK-ja do të angazhohet për ndërtimin e konsensusit në nivel kombëtar për procesin e dialogut dhe jo me formula artificiale jashtinstitucionale sepse ato nuk i zgjidhin çështjet e rëndësishme siç është dialogu dhe të tjerat.

Përmbyllen trajnimet për zyrtarët komunalë për procedurat e trajtimit të ndërtimeve pa leje

Prishtinë, 20 shtator (ER) - Në Prishtinë është mbajtur punëtoria e fundit prej gjashtë sa janë zhvilluar gjithsejtë në rajone të ndryshme të Kosovës dhe që kanë mbuluar të gjitha komunat.

Qëllimi i këtyre punëtorive ishte shpjegimi i procedurave nga udhëzimet administrative të dala nga Ligji për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, të organizuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), përkatësisht Departamenti për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim (DPHNB), në bashkëpunim me Programin e USAID-it për Qeverisje Ekonomike në Kosovë.

Sikurse në të gjitha punëtoritë, edhe në Prishtinë zyrtarët e DPHNB fillimisht shpjeguan aktivitetet në të cilat është angazhuar DPHNB dhe që kanë për qëllim lehtësimin e zbatimit të procesit të trajtimit të ndërtimeve pa leje, duke përfshirë aktivitetet e koordinimit me institucionet e tjera siç është përgatitja e udhëzuesve të detajuar për procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje. Gjithashtu, u prezantuan edhe procedurat e detajuara për trajtimin e kategorive të ndryshme të ndërtimeve pa leje.

Përfaqësuesit e Programit të USAID-it për Qeverisjen Ekonomike në Kosovë prezantuan skemat grafike të përgatitura nga ky program në bashkëpunim me DPHNB dhe që shpjegojnë fazat e ndryshme procedurale në mënyrë grafike.

Pas përfundimit të prezantimeve, u zhvillua një diskutim ndërmjet zyrtarëve komunalë të pranishëm dhe zyrtarëve të DPHNB-së ku u ofruan sqarime lidhur me disa çështje procedurale të ngritura nga zyrtarët komunalë. Gjithashtu, u theksua se DPHNB do t'i mbledhë të gjitha pyetjet dhe kërkesat për sqarim të ngritura gjatë të gjitha punëtorive të planifikuara dhe do të bëjë përpjekje maksimale për adresimin e këtyre çështjeve në udhëzuesit e detajuar të cilët janë në përgatitje e sipër. Në gjashtë punëtoritë e zhvilluara këtë muaj morën pjesë mbi 200 zyrtarë komunalë nga komunat e Republikës së Kosovës.

Lansohet programi i skriningut të kancerit të qafës së mitrës në Komunën e Mitrovicës

Mitrovicë, 20 shtator (ER) - Të premten zyrtarisht u lansua programi i Skriningut të Kancerit të Qafës së Mitrës në Komunën e Mitrovicës, program ky që po bëhet i mundur si rrjedhojë e suksesit të programit në Prishtinë dhe Prizren. Ngjarja u realizua me qëllim të prezantimit të programit mbi skriningun e kancerit të qafës së mitrës në Mitrovicë, që është pjesë e Programit Nacional për Kontrollin e Kancerit në Kosovë.

Ky program do ta mundësojë ofrimin e Pap testit për rreth 250 gra nga Komuna e Mitrovicës gjatë fazës së parë të implementimit, gjegjësisht deri në fund të vitit 2019. Po ashtu, do të ndërtohen kapacitetet për skrining brenda Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH) në Mitrovicë si dhe do të ndërtohet algoritmi procedural që rregullon sistemin e bashkëpunimit në mes të KPSh-së dhe Kujdesit Dytësor Shëndetësor - Laboratorit të Patologjisë.

Përpos ofrimit të këtij shërbimi të ri në kuadër të kujdesit parësor, palët synojnë, po ashtu, që të iniciojnë diskutime në mes të institucioneve dhe grupeve të interesit me qëllim të hartimit dhe implementimit të politikave shëndetësore që ndërtojnë një sistem cilësor të skriningut të kancerit të qafës së mitrës si e drejtë shëndetësore, e paraparë me Ligjin për Shëndet Riprodhues, si dhe e planifikuar në Programin Nacional për Kontrollin e Kancerit.

Ky program, përmes Pap testeve për gratë dhe vajzat nga Komuna e Mitrovicës, do të mundësojë zbulimin e hershëm të qelizave jonormale të qafës së mitrës dhe trajtimin e tyre me sukses për ta parandaluar kancerin e qafës së mitrës.

Me moton 'Të gjithë në mbrojtje të ujit' organizohet aksion për pastrimin përreth liqenit 'Batllava' në Orllan

Orllan, 20 shtator (ER) - Nesër (e shtunë) me fillim në orën 11:00 në Orllan, me moton 'Të gjithë në mbrojtje të ujit', organizohet aksion pastrimi përreth liqenit "Batllava". "OJQ 'Sundimi i demokracisë në Kosovë' vazhdimisht ka organizuar aktivitete vullnetare për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, veçanërisht të lumenjve që përshkojnë zonën e Orllanit. Fokusi do të jetë në Liqenin Batllava, duke pastruar sipërfaqen e cila ka mbetur pa ujë si dhe pastrime nga mbeturinat brenda liqenit duke përdorur barkat", është thënë në njoftimin e OJQ - SDK.

Ky aktivitet organizohet në kuadër të projektit "Aktivizmi qytetar dhe institucional për përmirësimin e gjendjes së mjedisit për ujë cilësor", projekt ky i cili mbështetet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe implementohet nga OJQ SDK.

Kandidati për kryeministër i koalicionit Nisma-AKR-PD ka prezantuar prioritetet e veta

Limaj: Kosovës i duhet një qeveri reformatore

Kandidati për kryeministër i koalicionit Nisma-AKR-PD, Fatmir Limaj, ka deklaruar se qeveria e ardhshme duhet të lë gjurmë të një qeverie reformatore. Në debatin "Fol hapur", në të cilin ka prezantuar prioritetet e veta si kandidat për kryeministër, Limaj ka vlerësuar se duhet të shikohet funksionimi institucional duke iu përshtatur synimeve dhe objektivave të reja të shtetit. Ai ka treguar se prioritetet kryesore të tij si kryeministër do të jenë: politika e jashtme, dialogu, bujqësia dhe paketa sociale

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Kandidati për kryeministër i koalicionit Nisma-AKR-PD, Fatmir Limaj, ka bërë me dije se Kosovës i dihet një qeveri reformatore.

Në debatin "Fol hapur" të organizuar nga Lëvizja Fol, ai ka thënë se ka ardhur koha të shikohet i gjithë funksionimi i sistemit shtetëror. Sipas tij, tani duhet t'u përshtatet të gjithçka ambicieve dhe objektiva të Kosovës. "Besoj se ka ardhur një moment, ndoshta edhe i vonuar, që qeveria e ardhshme të ndërtohet dhe të lë gjurmë të një qeverie reformatore. Është një moment i rëndësishëm ku duhet të rishikohen organet shtetërore, të rishikohen agjencitë dhe krejt sistemi funksional i këtij vendi për t'ia përshtatur ambiciet dhe objektivat Kosovës. Deri më tani funksionimi institucional i Kosovës ka pasur objektiv rrumbullakimin e shtetësisë dhe ka qenë e natyrshme logjika e funksionimit të deritashëm", ka thënë Limaj.

Ai ka bërë me dije se vendi ka nevojë që liderët politikë të ndërtojnë një konsensus për temat kombëtare në mënyrë që këto çështje të tejkalohen më lehtë. "Janë disa tema të cilat e presin vendin, që ne i quajmë tema nacionale. Besoj se është një moment i mirë ku duhet qartësisht të identifikohen interesat nacionale, të gjendet rruga e bashkëpunimit, ku faktori politik, pavarësisht nëse është pozitë apo opozitë, duhet t'i identifikojë ato tema dhe të bashkëpunojmë ngushtësisht për t'i tejkaluar apo për t'i zgjidhur", është shprehur ai.

Lideri i Nismës Socialdemokrate ka folur edhe për prioritetet e veta kryesore nëse do të jetë kryeministër i ardhshëm i vendit. Sipas tij, prioritetet kryesore do të jenë politika e jashtme, bujqësia dhe paketa sociale. "Prioritet imi kryesor është dialogu, politika e jashtme, pastaj bujqësia. Ne besojmë shumë se bujqësia është promotor i zhvillimit ekonomik të vendit. Bujqësia ofron mundësi për vende të reja pune, ofron mundësi për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Kosova duke investuar në bujqësi ka mundësi jashtëzakonisht të mira për t'i rritur buxhetet familjare, komunale dhe buxhetin shtetërore", ka thënë ai, duke treguar se çka duhet të bëhet në këtë sekret: "Kur flas për bujqësinë ideja ime është që në sektorin e bujqësisë ta bëjmë zonimin e Kosovës. Të dihet qartë se në cilën zonë çka kultivohet dhe çka investohet, apo si të ndihmohet fermeri ynë apo njerëzit tanë që kanë vendosur të merren me bujqësi", është shprehur. Më tej, ai ka treguar se objektiv tjetër i tij do të jetë paketa sociale. "Objektivi ynë i dytë është paketa sociale. Në vitet e fundit jemi munduar ta fusim çështjen sociale në agjendën e Kuvendit dhe qeverisë, por ndërprerja e mandatit ka lënë punët në gjysmë e të cilat duhet të vazhdohen. Paketa sociale nuk përfundon në një mandat. Ai është një angazhim permanent dhe në të duhen të bëhen reforma të thella sociale", ka thënë Limaj.

Kandidati për kryeministër i koalicionit Nisma-AKR-PD ka thënë se Kosova e ka për obligim ta bëjë sigurimin social dhe sigurimin shëndetësor. Sipas tij, pa sigurim shëndetësor nuk mund të ketë shëndetësi të mirëfilltë.

Limaj i ka dhënë idetë e veta edhe për reformën në drejtësi. "Duke respektuar pavarësinë e institucioneve të drejtësisë ne së bashku me ekspertët duhet të ndërtojmë kritere të cilat qartësisht masin performancën e njerëzve që merren me drejtësi, prej prokurorëve, gjyqtarëve e deri te hetuesit", është shprehur Limaj.

Sa i përket dialogut me Serbinë, ai ka thënë se do ta japë maksimumin për zhbllokimin e këtij procesi. "Në tavolinën time do të jetë zhbllokimi i dialogut me Serbinë. Të mos kthehemi në situatën që kemi qenë. Të tregojmë seriozitetin tonë që ne jemi të gatshëm. Kur është ngritur taksa është ngritur zhvillimi ekonomik i vendit. Duhet të kemi një negociatë me taksën për t'u zhvilluar dialogu", ka thënë Limaj.

Ai ka deklaruar se pa një përmbyllje të temave të hapura me Serbinë nuk do të ketë zhvillim të vendit. "Këto investime janë të domosdoshme për ta rritur zhvillimin ekonomik. Për të pasur investime duhet siguri dhe drejtësi. Siguri do të thotë mbyllja e çështjes me Serbinë. Qeveria e Kosovës detyrën e parë e ka këtë çështje. Dialogu do të jetë tema qendrore. Një marrëveshje e mundshme me Serbinë duhet të ketë besimin në Kuvend dhe të qytetarëve. Asnjëherë nuk ka ndryshuar mendimi im për taksën. Taksa u vendos dhe do të hiqet kur pushojnë arsyet. Mendoj se duhet të kemi negociata edhe për taksën", ka deklaruar Limaj.

Në këtë debat Limaj është pyetur se me kë mund të bëjë bashkëpunim pas zgjedhjeve. "Një ministër nuk mund të bëjë vetë reforma. Duhet vullneti i kryeministrit. Unë nuk do të pranoja të bashkëpunoja nëse nuk merremi vesh për pikat programore", është shprehur Limaj.

Haradinaj: Amerika nuk ka kërkuar kompromise të dhimbshme për Kosovën

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, duke iu përgjigjur pyetjeve të qytetarëve drejtpërdrejt në faqen e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) në "Facebook", është pyetur të premten edhe për raportin e Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kërkesat e saj kundrejt qeverisë. Haradinaj ka thënë se ShBA-ja nuk ka kërkuar asnjëherë kompromise të dhimbshme. "Nuk është e vërtetë që Amerika ka kërkuar kompromise të dhimbshme. Nuk e ka kërkuar Amerika ndarjen e Kosovës", ka thënë Haradinaj në paraqitjen e tij në llogarinë e vet në "Facebook". Gjithashtu, Haradinaj ka thënë se ShBA-ja nuk ka kërkuar mosbërjen e ushtrisë.

Kosova koordinon 157 shtete për pastrimin e botës

Qendresa RAMA

Prishtinë, 20 shtator - Sot (e shtunë) "Let's Do It" (Ta Pastrojmë Kosovën) do ta udhëheqë Ditën për Pastrimin e Botës pas disa muajve koordinim të fushatës për aksion më të madh qytetar kundër mbeturinave.

Ekipi i Kosovës, në bashkëpunim me ekipin nga Estonia, do t'i udhëheqin aksionet në 157 shtete të botës me aktivitete pastrimi. Kosova, si shembull i suksesshëm në organizimin e fushatave, ideve dhe aktiviteteve kreative, tërhoqi vëmendjen në të gjithë botën, andaj iu besua koordinimi që të bëhet qendra e botës për të gjitha shtetet në aktivitetin e pastrimit.

Aktivitetet e Ditës së Pastrimit të Botës do të pasqyrohen përmes një transmetimi drejtpërdrejt 24 orësh që do të shfaqet në rrjetet sociale dhe në kanalin e katërt të Televizionit Publik të Kosovës.

Gjatë 21 shtatorit, mbi 157 shtete të ndryshme të botës do të raportojnë në Qendrën e "Let's Do It" në Kosovë për aktivitetet që organizojnë në shtetet e tyre.

Kosova ka krijuar Qendrën e Thirrjeve, e cila do të operojë në Shkollën Finlandeze në Kosovë dhe do ta nisë punën sonte, në mesnatë deri nesër, kur edhe do të përfundojnë të gjitha aktivitetet që organizohen në kuadër të Ditës së Pastrimit të Botës.

Për këtë të premten u mbajt edhe një konferencë për media, në të cilën morën pjesë drejtori i Fushatës për Ditën e Pastrimit të Botës, Luan Hasanaj, udhëheqësja e Rrjetit Global "Let's Do It World", Heidi Solba dhe ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Kosovës, Fatmir

Matoshi, të cilët u bënë thirrje të gjithë njerëzve që të bashkohen në aktivitetet për pastrimin e botës.

Përmes fushatës për Ditën e Pastrimit të Botës, ekipi i "Let's Do It" ka promovuar vazhdimisht vlerat dhe pasuritë natyrore të shtetit të Kosovës në 157 shtete të ndryshme të botës. Kosova koordinon aktivitetin "Për një botë më të pastër".

FSK-JA REALIZON ME SUKSES MARSHIMIN 'GJERAVICA 2019'

Prishtinë, 20 shtator (ER) - Pjesëtarët e Kompanisë së Taksë Forcës së Kërkim-Shpëtimit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) të Forcës së Sigurisë të Kosovës, në bazë të planit të trajnimeve dhe aktiviteteve për vitin 2019, kanë realizuar marshimin kondicional "Gjeravica 2019" mbi 15 km të gjatë.

Marshimi i njësisë së forcës operative u realizua në kushte jo të mira atmosferike, në një lartësi mbidetare prej 2656 metrash nga "Bjeshkët e Junikut" deri në majën e malit "Gjeravica". Marshimi kishte për qëllim përgatitjen fizike të pjesëtarëve të FSK-së në përballje me sfidat. Të gjithë pjesëtarët e kësaj kompanie arritën që me sukses ta realizojnë këtë marshim mjaft sfidues.

Haradinaj mori pjesë në 20-vjetorin e themelimit të RTV Mitrovica

Mitrovicë, 20 shtator (ER) - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, mori pjesë të premten në 20-vjetorin e themelimit të RTV Mitrovica. Me këtë rast, kryeministri në detyrë, Haradinaj, e ka përgëzuar drejtorin e këtij televizioni, Nexhmedin Spahiun, për rolin e tij, duke e quajtur ithtar të së drejtës, të lajmit dhe debatit të lirë përmes RTV Mitrovica, njëkohësisht i ka ndarë atij medaljen e kryeheroit tonë, "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu". "E kam shfrytëzuar të drejtën time si kryeministër në detyrë që të ndaj një dekoratë të Gjergj Kastriotit - Skënderbeut për kontributin e tij në median e lirë", ka thënë kryeministri në detyrë Haradinaj.

Ndërkaq drejtori i RTV Mitrovica, Nexhmedin Spahiu, ka pohuar se sot 20 vjet më parë është themeluar Radio Televizioni i Mitrovicës nga një grup entuziastësh me vizion të qartë medial, shoqëror, politik e njerëzor. "Sot 20 vjet jemi larg nga ajo që kemi menduar se do të jetë Radio Televizioni i Mitrovicës, por është e pabesueshme se si kemi kaluar nëpër gjithë ato sfida. Por, nëse

mendojmë se çfarë kemi bërë për këta 20 vjet dhe për çfarë shquhet televizioni i Mitrovicës, janë tri fusha ku Radio Televizioni i Mitrovicës ka qenë pionier e që, sipas tij, kanë qenë programi për fëmijë, që është redaktuar nga fëmijët dhe tani janë rreth 38 fëmijë të cilët e bëjnë aktualisht këtë program, pastaj bashkëpunimi ndëretnik dhe fusha e tretë që kishte rol të pazëvendësueshëm ishte debati", ka thënë Spahiu.

Pjesëmarrës në këtë ngjarje ishin kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, shefi i OSBE-së në Kosovë, Jan Braathu, ambasadorë të akredituar në Kosovë, përfaqësues të mediave të ndryshme, përfaqësuesit e KPM-së si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Veseli: Plani Kundër Korrupsionit do të krijojë kushte më të favorshme për bizneset

Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 20 shtator - Lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, para qindra biznesmenëve ka shpalosur planin ekonomik të PDK-së. Ai ka shprehur mirënjohje për iniciativën, guximin, punën, talentin dhe inovacionin e biznesmenëve të cilët ka thënë se janë motori i rritjes ekonomike të Kosovës dhe gjeneratorët e vendeve të reja të punës për të rinjtë tanë. "Në qeverisjen e ardhshme nuk do t'u ngarkojmë me asnjë tatim të ri dhe nuk do t'i rrisim tatimet ekzistuese. Përkundrazi, do t'jua bëjmë punën më të lehtë e do t'ju ndihmojmë të keni sukses përmes lirimeve, investimeve publike, incentivave financiare dhe eliminimit të burokracisë. Po flas për një strategji vendimesh dhe veprimesh konkrete. Kosova nuk mund të përmirësojë çdo sektor në një moment, por mund të ketë disa prioritete kryesore strategjike. Duke marrë për bazë përparësitë dhe mangësitë e veta, prioritete kryesore do të jenë ekonomia prodhuese dhe punësimi. Këtë askush nuk mund ta bëj më mirë se sektori privat, ndërmarrësia", ka thënë Veseli.

Programi i tij ai ka thënë se bazohet në një ekonomi të dijes dhe inovacionit që implikon ndërmarrësit, në kërkim, zhvillim dhe pjesën akademike. "Paralelisht me to do të ketë politika sociale aktive. Për t'i arritur të gjitha këto, parakusht është instalimi i sundimit të ligjit. Për këtë arsye prioriteti im i parë është lufta kundër korrupsionit dhe nepotizmit. Kjo luftë do ta ndalojë konkurrencën jolojale, garanton mundësitë e barabarta, ndalon vonesat e zvarritjet e çështjeve komerciale", ka thënë ai.

Një ndër pikat e këtij plani Veseli ka thënë se është krijimi i Gjykatës Komerciale si një institucion gjyqësor i specializuar,

profesional, i përshtatur për t'u ardhur në ndihmë bizneseve, duke zgjidhur në mënyrë të shpejtë dhe të drejtë të gjitha kontestet ekonomike.

Sistemi i drejtësisë, i reformuar falë këtij plani, sipas Veselit, do ta garantojë paprekshmërinë e pronës dhe zbatueshmërinë e kontratës, duke krijuar një klimë biznesi të drejtë, transparente, të sigurt dhe të parashikueshme.

Deficiti tregtar i Kosovës kalon mbi tre miliardë euro

Prishtinë, 20 shtator - Kosova ka një deficit vjetor tregtar që arrin shifrën mbi 3 miliardë euro. Ky deficit tregtar, sipas ekspertëve, është i lartë dhe vjen si pasojë e mospërputhjes ndërmjet vlerës së eksporteve dhe të importeve. Si i tillë, deficiti në këtë nivel, nënvizojnë ekspertë të ekonomisë dhe përfaqësues të bizneseve, ndikon edhe në zhvillimin ekonomik të vendit.

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për vitin 2018, vlera e importit të produkteve të huaja në Kosovë kishte arritur shifrën mbi 3 miliardë euro, kurse eksporti i produkteve të Kosovës në vendet e rajonit dhe Evropës ishte mbi 350 milionë euro.

Ndërkaq, në të dhënat e fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës të publikuara në raportin "Tregtia e Jashtme e Mallrave në Kosovë", theksohet se eksporti i mallrave në muajin korrik 2019 kishte vlerën 40.4 milionë euro, ndërsa importi kishte vlerë 336.8 milionë euro. Këto shifra tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 5.3 për qind në muajin korrik 2019 në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Deficiti tregtar, sipas BQK-së, ka shënuar rritje nga viti në vit.

Kjo situatë nga ekspertë të çështjeve ekonomike dhe përfaqësues të bizneseve konsiderohet të jetë e dëmshme në përgjithësi për zhvillimin ekonomik të vendit.

Naim Gashi, ekspert i çështjeve ekonomike, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se Kosova duhet ta ulë varësinë e ekonomisë së Kosovës nga importi nëpërmjet nxitjes së prodhimtarisë vendore. Por, sipas tij, ajo që po pamundëson zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e prodhimtarisë vendore është pabarazia në treg. "Fatkeqësisht, Kosova ka një deficit të lartë tregtar që tejkalon tre miliardë euro në vit, që do të thotë se vetëm 1 me 10 e importit të mallrave dhe prodhimeve të cilat vijnë në Kosovë, mbulohen nga eksporti që, shprehur në shifra, 1 me 10 e kemi proporcionin e bilancit tregtar me botën e jashtme. Pavarësisht prej disa skemave publike të përkrahjes së prodhimit vendor, megjithatë hendeku i deficitit të lartë tregtar me botën e jashtme po thellohet në vazhdimësi, pasi që këto skema nuk po japin efektet e dëshiruara për shkak të korrupsionit të nivelit të lartë që ekziston në Kosovë dhe pabarazisë në treg", ka thënë Gashi.

Kosova vazhdon të ketë një sektor jokonkurrues të prodhimit. Prodhuesit në Kosovë në vazhdimësi kanë theksuar se përballen me probleme të shumta, si tatimet e larta mbi vlerën e shtuar, ekonominë joligjore, financimin e vështirë për bizneset, normat e larta të interesit, jostabilitetin me

energji elektrike, konkurrencën e pabarabartë.

Gashi thekson se të gjitha këto probleme duhet të eliminohen për ta përmirësuar bilancin tregtar. "Bizneset në Kosovë, të cilët kanë lidhje me pushtetin, janë të favorizuara në treg dhe zakonisht marrin projekte nga fondet publike, ndërsa ato të cilat investojnë në kapacitetet e fuqisë punëtore dhe në teknologji, ato nuk janë konkurrente në treg për shkak të pabarazisë", ka thënë Gashi.

Kurse kryetari i Aleancës Kosovare të Biznesit, Agim Shahini, ka deklaruar për "Radion Evropa e Lirë" se deficiti i lartë tregtar është një dukuri e cila po pamundëson zhvillim dhe rritje ekonomike në vend. "Kosova vuan ende nga mungesa e një dokumenti kombëtar, pra një strategjie kombëtare për zhvillim ekonomik, ku do t'i vendoste prioritetet e veta. Njëra prej tyre është edhe zvogëlimi i deficitit tregtar, duke e zëvendësuar atë me prodhim vendor. Që nga mbarimi i luftës Kosova ka pasur deficit tregtar me miliarda euro. Kjo neve na bënë të jemi të varur nga importi, nga inflacioni dhe vazhdimisht të jemi vendi që eksporton para të gatshme, qoftë të taksapaguesve, qoftë paratë e buxhetit dhe, po ashtu, remitencat - paratë që vijnë nga diaspora", ka thënë Shahini.

Ndërsa guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, në një intervistë për Radion Evropa e Lirë pati thënë se me një fokus më të madh në sektorin ekonomik, Kosova mund të arrijë një rritje ekonomike prej 6 deri në 7 përqindësh, e cila brenda një periudhe të shkurtër kohore do të mund të adresonte dy nga problemet me të cilat përballet vendi, siç janë papunësia dhe deficiti i lartë tregtar.

BISEDIMET ME SERBINË PËRCAKTOJNË KOALICIONET PAS ZGJEDHJEVE DHE QEVERINË E RE E JO REZULTATI I ZGJEDHJEVE

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Fushatë egërshane, me fatura pa mbulesë: Fushata për zgjedhjet e parakohshme është në përfundim e sipër ende pa filluar zyrtarisht! Zyrtarisht, kjo fushatë duhet të fillojë më 25 shtator dhe të përfundojë më 5 tetor, mirëpo subjektet politike garuese dhe koalicionet thuaja e kanë kryer punën e madhe dhe tani ka mbetur vetëm t'i nënshkruajnë faturat e premtimeve gjatë fushatës së ligjshme. Tash i kemi listat me kandidatë që janë certifikuar nga KQZ-ja dhe vetëm pritet të realizohen rezultatet e votimeve që i kanë bërë ambasadorët e fuqishëm në Kosovë, zyrtarë të BE-së, Donald Tramp, Pompeo, Metju Pallmer dhe të tjerët në mënyrë që t'i kemi të qartë koalicionet pas zgjedhjeve si dhe përbërjen e re të qeverisë së Kosovës e cila për bazë do t'i ketë votat e personaliteteve të përmendura më lart e jo se çfarë do të ofrojnë dhe prodhojnë kutitë e votimit. Subjektet dhe koalicionet garuese kanë hyrë realisht në luftë dhe dallohet vetëm lloji i armatimit verbal që e përdorin në këtë luftë. Fjalorin më "kërcënues" po e përdorin subjektet që as të kaluarën, as të tashmen e as përmbajtjen nuk e kanë të dhunshme, partia e doktorëve dhe akademikëve që kanë tituj si kalavesh rrushi, por se kanë probleme elementare me përdorimin e drejtë të gjuhës shqipe duke përjashtuar nga ky alfabet disa shkronja që janë tepricë teknologjike për faktin se nxjerrin shumë probleme sikur që janë shkronjat: ë, gj, xh, ç dhe q, si më të ngatërruara dhe disa më lehtë për t'i kuptuar dhe vendosur në fjali, të thjeshta, si më të lehta dhe më praktike. Besoj se LDK-ja është dashur ta angazhojë Zafirin për një kurs intensiv të rregullave të drejtshkrimit. Tash, pak për listat dhe premtimet:

1. LDK: Po e vendos në vend të parë sepse edhe mund t'i fitojë zgjedhjet apo të jetë e dyta, pas PDK-së. Listat e LDK-së janë lista tradicionale dhe në kuptimin e korrupsionit (të zbuluar) janë 100 % të pakriminalizuara. Kjo listë është tarator midis elefantëve të vjetër që moti janë gati për të shkuar te varrezat politike dhe vendimmarrëse dhe, të skifterëve të rinj, pa kthetra dhe pa sqep goditës dhe shpues. Në betejën me dema në Spanjë bëhet një hile kur demave të rrezikshëm, për të mos e rrezikuar toreadorin, i topiten brirët me një limë por se brirët mbesin si kërcënim, më shumë vizual sesa funksional. Edhe skifterët e LDK-së, që kanë aderuar këto katër vjetët e fundit me ambicie të mëdha që, përmes reformimit demokratik të LDK-së, ta marrin pushtetin duke i nxjerrë nga loja "old timerat" apo pleqtë e këtij subjekti politik që ka luajtur rol në historinë e re të Kosovës. Skifterëve të LDK-së, edhe sot u kanë mbetur vetëm fjalët sepse "old timerat" apo pleqtë e kësaj partie janë ata që marrin vendime. Shembull për këtë i keni zgjedhjet për kryetarë të komunave ku pleqtë e LDK-së i rrahën keq skifterët pa sqep goditës dhe me kthetra të topitur, si brirët e demave të Spanjës. Madje, le të ndihen të lumtur që i futën në lista për deputetë! Tash pleqtë e LDK-së që kanë bartur barrën që nga themelimi (viti 1989) e deri më sot, si kompromis e futën në lojë Vjosa Osmanin që dikur e shqelmonin sa herë që e kishin afër, kurse sot derdhin lot gëzimi sikur dikur kur paraardhësit e kësaj partie qanin nga gëzimi kur e takonin shokun Tito apo shokun Slloba. Nëse LDK e ka një listë të pakriminalizuar, që edhe e ka, fjalori në fushatë është i dhunshëm, përjashtues dhe kërcënues, në mungesë të një oferte serioze politike, ekonomike, reformatore dhe zhvillimore. Deri më tani vetëm kemi dëgjuar se si PDK-në do ta dërgojnë në opozitë, se si do ta pensionojnë në bisedime Hashim Thaçin - Shimën dhe si do ta dërgojnë jashtë postit Aleksandër Lumezin - Lekën. Pse e thotë këtë Albini i cili ka një profil tjetër të shkollimit edhe i falet, por nuk i falet kurrsesi kandidates për kryeministre të LDK-së, Vjosa Osmanit, e cila ka përfaqësuar para Gjykatës Kushtetuese të Kosovës LDK-në dhe ish-presidentin Sejdiu, anëtar i kësaj partie. Fati nuk i ka ecur dhe i ka humbur të gjitha rastet por, mendoj se nga këto pësime është dashur të nxjerrë mësime; as nuk mund ta dërgojë në pension politik Hashim Thaçin - Shimën edhe nëse i siguron 120 vota në Kuvendin e Kosovës e as ta shkarkojë Lekë Lumezin. Sa i përket betimit dhe porosive që i dërgon nga "vatrat e luftës", se kurrë nuk do të bëjë koalicion me PDK-në, të mos ngutet, le t'i presë rezultatet e zgjedhjeve dhe qeverinë e formuar, jo për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, por për të bërë bisedime me Serbinë duke e hequr taksën 100 % e që, pa asnjë dyshim, do ta bëjë. LDK-ja pjesën më të madhe të pasluftës e ka kaluar në shtratin e PDK-së duke kaluar, herë çaste të mira, herë jo të mira, sikur në çdo shkërdhyerje që ndodh. Ama raporti edhe korruptiv midis LDK-së dhe PDK-së ka qenë konsensual, të dyja palët kanë përfituar. Nuk mjafton t'i flakni brekët e palara e ta fitoni pastërtinë pasi jeni shkërdhyer një kohë aq të gjatë. Shumë herë krerët dhe kokat e LDK-së kanë deklaruar se nuk do të bëjnë koalicion me PDK-në, por kurrë nuk i kanë rezistuar tundimit nga PDK-ja. Në shenjën më të vogël, vullnetarisht kanë shkuar drejt shtratit. Jo pse ua kënda shkërdhyerja, por për shkak se janë parti shtetndërtuese dhe institucionaliste prandaj, interesi i shtetit dhe i popullit është mbi interesin partiak. A do të jetë kështu pas zgjedhjeve të 6 tetorit 2019? Deri më tani LDK-ja e ka fushatën e paartikuluar dhe votat po i kërkon nga Gjykata Speciale, Varri i Ibrahim Rugovës, vrasjet e pasqaruara të pasluftës, urrejtja ndaj PDK-së dhe UÇK-së sikur edhe përkrahjen që po i japin Vjosa Osmanit, jo si kapacitet politik, por si femër dhe kjo përkrahje po vjen nga partia simotër evropiane, nga Universiteti ku ka studiuar në Amerikë dhe nga disa personalitete që ju përkrahin ekskluzivisht në baza gjinore. Kjo përkrahje nuk i mjafton Vjosa Osmanit madje, në disa raste, besoj se e dëmton shumë!

2. PDK: Derisa të gjithë po e refuzojnë ditën, PDK-ja po e bën gati shtratin për natën kur edhe luhen lojërat e mëdha dhe ato kryesore; politike dhe seksuale e që, në rrethanat tona, nuk ka fare dallim. PDK-ja nuk kërkon partner të përkryer dhe të virgjër; i duhet partner sa për t'i përmbushur boshllëkun e shtratit - pushtetit. Po hyre në atë shtrat, edhe nëse je i pajisur me rripin e virgjërisë që ua vendosnin dikur kalorësit dhe fisnikët grave të tyre kur shkonin në ekspedita të gjata luftarake, përsëri do ta lini "virgjërinë" politike dhe "parimore" në shtratin e hamshorit, me një traditë 20-vjeçare të shkërdhyerjes politike - PDK-së! Është interesant sa shumë e shajnë ditën kurse natën, nën hije të hënës, shtyhen para krevatit të PDK-së se kush do të jetë i pari! Edhe tash, askush nuk e do, por të gjithë e dëshirojnë. PDK-ja po e bën fushatën më paqësore sesa që e bënin Ibrahim Rugova dhe Gandi. Po vepron sipas mësimeve të Biblës; të gjithëve po ua kthen faqen që ta godasin, askujt nuk po ia kthen goditjen! Ruleti rus apo oferta e PDK-së! E ka bërë një listë që ka më së shumti emra të rinj dhe figura që, jo se nuk ishin me PDK-në, por se as sot e kësaj dite nuk e ndiejnë veten si anëtarë të PDK-së. Po e shfrytëzon me mjeshtëri fushatën amatore të LDK-së sikur edhe strukturën e ashtëzuar organizative që e ka ruajtur thuaja të paprekur që 20 vjet! Dikush e ka mësuar shumë mirë Kadri Veselin se si ta bëjë listën e kandidatëve për deputetë, duke u dhënë përparësi ardhacakëve apo muhaxhirëve politikë (të larguar apo të përndjekur nga partitë e tjera). E ka forcuar Prishtinën me kandidatë si Merita Makollin, Shqip Demaçin, Abelardin dhe të tjerët, Ferizajn e ka bërë thuaja dominion të ish-vartësit tim të ShIK-ut (Shërbimi Informativ i KMDLNj-së) Ilmi Reçica, Hajdari po ia stabilizon shumë Gjakovën, Prizreni ka qenë i fortë edhe më parë, me largimin e Hasan Prishtinës - Agim Bahtirit nga AKR-ja edhe Mitrovicën e ka në grusht, e ka huqur keq me Podujevën, Gjilanin dhe Anamoravës së imperatorit Haziri mund t'ia marrë ndonjë votë, Pejën e ka të lodhtë, kurse Drenicën, të Kuqe dhe të Zezë (Drenica kuqezi) e ka me vete, Shtimen, Çakanikun dhe do vende të vogla i ka me pozicione të forta. Kadria po e bën fushatën e mirë dhe fort paqësore. Shumë edhe nuk i besojnë, mirëpo nuk e besoj se do të ndahet keq. Në mos për asgjë tjetër, bisedimet me Serbinë nuk e lënë jashtë loje. PDK-ja e heq taksën, pa asnjë dyshim vetëm se është kërkesë ndërkombëtare. Deri vonë ka marrë përgjegjësinë, pa bërë fare ADN-në për atësinë e kësaj takse. Po duket se kurrë nuk ka qenë i kënaqur me fëmijën (taksën 100 %) e porsalindur, prandaj ka qenë kundër saj. Këtu është një problem: ose PDK-ja ka qenë prind i papërgjegjshëm dhe nuk e ka edukuar fëmijën si duhet, ose fëmija i ka dalë jashtë dorës! Ata që po mendojnë se aq lehtë e dërgojnë PDK-në në pension politik e kanë gabim sepse PDK-ja nuk mund të llogaritet si pensionist i moshës, por është kontributdhënës në të gjitha proceset nëpër të cilat ka kaluar Kosova, herë duke qëndruar krenarë dhe ballëlartë, herë duke u gjunjëzuar, por se asnjëherë nuk u shtri për toke. Nëse nuk del partia fituese atëherë mund të jetë partia e dytë! Më shumë në saje të gabimeve të partive të tjera. Dhe punës së madhe në terren!

3. LV: E ka një listë me emra të aktivistëve të hershëm të LV-së dhe ardhacakëve që duan të bëjnë karrierë duke kaluar "Rrugën e trëndafilave", pa shumë investime dhe pa shumë mundime. Në disa procese nëpër të cilat ka kaluar Kosova, LV ka luajtur rol historik jo se i ka pamundësuar disa procese,

por se i ka ngadalësuar në zbatim, duke i vonuar e që e kanë humbur peshën që e kishin po të ishin zbatuar sipas dinamikës së paraparë nga bashkësia ndërkombëtare. Me kohë i ka identifikuar proceset e dëmshme sikur një mjek që saktësisht e përcakton diagnozën, por se nuk ofron terapi përkatëse për shërim. LV është rast tipik i parimit të shpërputhjes së madhe midis asaj që është e drejtë dhe që e dëshironi dhe asaj që mund ta realizoni. Lojën për koalicion parazgjedhor me LDK-në e humbi sepse ra në kurthin e dhelprës politike, Isa Mustafës, kurse Albin Kurti, LDK-së i vendosi kurth për minj. Dhelprat asnjëherë nuk bien në kurth të minjve, kurse minjtë lehtësisht bien në kurthe të dhelprave! Në vend se gjatë fushatës të merret PDK (Memli Krasniqi) dhe AAK (Arian Agushi) me rep muzikë apo fushatë në ritëm, këtë po e bën rokeri Albin Kurti me: "Le të lëvizë Lumezi e të kthehet Elezi ...". Albini e ka të qartë se, as, edhe po të bëhet kryeministër i Kosovës, nuk do të lëvizë Lumezi e nuk do të kthehet Elezi e vetëm në ëndërr mund të shoh se mund ta shkarkojë Hashim Thaçin - Shimën. Ligjet aktuale, edhe si kryeministër, nuk i lejojnë këto transaksione dhe transferime. Ligji nuk përmbush dëshira por, në të shumtën e rasteve, rrënon dëshira! Në konstelacionin aktual politik ndërkombëtar, Albin Kurti e ka të vështirë, mos ta them të pamundur, të bëhet kryeministër edhe në rast se i fiton zgjedhjet, Albini ka bërë më së shumti salto mortale në vitet e fundit, por po merr në thua në bisedimet me Serbinë. Nuk ka kohë bota të merret me rishqyrtimin e marrëveshjeve të Brukselit! Bota kërkon zbatim të këtyre marrëveshjeve e jo rishikim! Albini sigurisht se ka vullnet (edhe nga hakmarrja) ta luftojë korrupsionin sepse jam i sigurt se nuk është i korruptuar, por se koha nuk po punon për të; nuk po kërkohet lufta kundër korrupsionit si prioritet, por prioritet absolut janë vazhdimi i bisedimeve me Serbinë dhe arritja e një marrëveshjeje. Vetëm pas kësaj do të aktualizohet lufta kundër korrupsionit dhe do të jetë koha e Albinit nëse deri atëherë mbijeton politikisht! Mendoj se rrethanat do të jenë përcaktuese që LV të mbetet ende në opozitë. Dhe mendoj se do të jetë më mirë për LV të ndodhë kjo! Në politikë nuk kalon urrejtja ndaj askujt, ndaj asnjë subjekti politik. Mund të ketë efekt momental pozitiv, por strategjikisht është urrejtja dhe përjashtimi) sport i kushtueshëm! LV-ja në variantin më të mirë mund të dalë e dyta por, objektivisht, mendoj se do të jetë partia e tretë. Nëse fiton do të jetë befasi e madhe, së paku për mua! Albini po thotë se taksën do ta zëvendësonte me reciprocitet të plotë. Nëse ndërkombëtarët janë 100 % kundër taksës, do të ishin 1000 % kundër reciprocitetit!

4. AAK dhe këmbaleci PSD: Do të fitojnë vota në saje të Ramushit, por 100 % nuk i fitojnë zgjedhjet. Ramush Haradinaj e ka bërë një potez shumë të mençur politik gjatë mandatit të përgjysmuar: të gjithë do të thonë se është vendosja e taksës 100 % për mallrat nga Serbia dhe Bosnja. Unë mendoj se ky ishte potezi nr. 2 i Ramushit, kurse potezi nr. 1 ishte mospranimi i marrjes së përgjegjësisë për dialog me Serbinë. Po ta merrte këtë përgjegjësi taksa nuk do të kishte fare efekt, kurse mosmarrja e përgjegjësisë e ka fuqizuar taksën. Po ta merrte Ramush Haradinaj përgjegjësinë e udhëheqjes së bisedimeve (monologut) me Serbinë nuk do të bënte asgjë tjetër përveç se do t'i lante pampersat e mbushur të Hashimit dhe Editës pas takimeve me bareshën Ashton dhe mashtruesen Mogerini! Kështu, të gjithë po e ndiejmë kundërmimin e bisedimeve pasi t'i kenë dhjerë Hashimi dhe Edita, por nuk kemi detyrim as t'i veshim ato brekushe e as t'i pastrojmë. Ramushi e ka një problem: nëse edhe hipotetikisht do të bëhej kryeministër i Kosovës, ku do të mbetej taksa 100 %?! Problem, për momentin, i pazgjidhshëm!

5. Nisma demokratikesociale dhe Aleanca e sabotuesit të njohjeve për Kosovën: Kësaj radhe nuk po komentoj asgjë sepse kam dilema të mëdha se do ta kalojë pragun. Nisma pa AKR-në 100 % në Kuvend, Nisma me AKR-në 100 % lë mëdyshje!

Zgjuarsia e munguar politike: Lista Serbe është parti e Serbisë në Kosovë, 100 % përfaqëson dhe mbron interesat e Serbisë dhe 100 % punon kundër interesave të Kosovës, të cilën nuk e njeh dhe nuk e pranon, as si shtet e as si entitet politik, i pavarur nga Serbia. Serbët e Kosovës rreth Sllobodan Petroviqit dhe Nenad Rashiqit duan të jetojnë në Kosovë dhe duan të integrohen në Kosovë. Për aq sa janë të përndjekur nga Serbia dhe marionetës së quajtur Lista Serbe, aq kanë qenë të përndjekur nga disa subjekte kosovare që janë shkërdhyer me Lista Serbska jo për shtet, por për pushtet!

Tash, po të kishim liderë që mendojnë pak më larg se interesi momental dhe hunda e tyre që është e operuar nga nuhatja e drejtë politike, ata do ti udhëzonin votuesit e tyre që të sigurojnë një numër të votave për Petroviqin dhe Rashiqin dhe vetëm në këtë mënyrë do të fuqizoheshin serbët që duan të integrohen në Kosovë dhe do t'i priheshin krahët një partie socialshoviniste siç është Lista Serbe. Po a mund të ndodhë kjo në Kosovë ?! Nuk e besoj.

Mos qofsha në lëkurën e fituesit të zgjedhjeve: Nuk ka më keq se t'i fitoni zgjedhjet dhe të veproni kundër vullnetit të votuesit! Kjo do të ndodhë në Kosovë sepse vullneti i votuesit do t'i nënshtrohet urdhrit të Zeusit; heqja e taksës, vazhdimi i dialogut me Serbinë dhe një marrëveshje që do të dhembë bukur shumë. Në çdo vend në botë zgjedhjet organizohen për t'i shëruar dhimbjet, vetëm te ne ndodhë e kundërta! Vërtet, a jemi një vend normal?!

CILA PARTI POLITIKE GUXON TA ZGJIDHË PROBLEMIN E KADASTRËS?

Shkruan: Dr. sc. Përparim AMETI

Problemi i pronave dhe përcaktimi i titullarëve të pronësisë është një problem shumë i madh dhe i ndjeshëm si në Kosovë, po ashtu edhe në vendet me një të kaluar komuniste. Është emergjent krijimi i një kadastre multifunksionale e cila do ta përmbante gjendjen më të fundit të së drejtës mbi pronën e paluajtshme dhe i cili do të ofrojë shërbime cilësore qytetarëve dhe investitorëve të mundshëm. Vetëm përmes këtyre sistemeve është e mundshme që të mënjanohen parregullsitë në menaxhimin ligjor dhe lokalizimin e saktë të çdo parcele dhe objekti tjetër kadastral.

Kosova duhet të bëjë hapa konkretë për krijimin e një agjencie kadastrale centraliste e cila jo vetëm se është kusht për inkuadrim në BE, por është edhe kusht shumë i rëndësishëm në investimet nga jashtë dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.

Përmes një institucioni të tillë të papolitizuar, do të mund të zgjidheshin problemet pronësore në mënyrë profesionale dhe do të krijoheshin kushtet për krijimin e një sistemi modern kadastral që do t'i garantonte të drejtat mbi pronat e paluajtshme dhe funksionimin e qëndrueshëm të hipotekizimit të këtyre pronave për qëllim kreditimi dhe garantimi bankar. Sistemi bankar modern i njeh vetëm hipotekat të cilat ofrohen nga një sistem i sigurt kadastral me evidencë të saktë mbi titullarin dhe hapësirën gjeografike të paluajtshmërive. Subvencionimi i fermerëve është shumë i vështirë në rastet kur titullarët faktikë nuk përputhen me titullarët ligjorë. Pra, në Kosovë rreth 90 për qind e "fletëve poseduese" nuk janë të pronarëve aktualë, por janë në emrat e individëve të një kohe të viteve '70 apo '80.

Problemi i komasacionit dhe ekspropriimit mund të zgjidhet vetëm përmes azhurnimit të të dhënave kadastrale me pronarët aktualë dhe ligjorë. Pra, ky problem mund të zgjidhet vetëm përmes një regjistrimi masiv të pronave, e që deri më tani nuk është trajtuar nga asnjë qeveri e Kosovës. Shpresojmë që qeveritë e ardhshme ta trajtojnë së paku këtë problem vital të qytetarëve dhe t'i japin fund njëherë e përgjithmonë problemit të pronave të paluajtshme në Kosovë.

Nxënësit e Akrashticës së Vushtrrisë botojnë libër me poezi

Vushtrri, 20 shtator (ER) - Libri me poezi "Ëndërrime fëmijërore", i nxënësve të Shkollës Fillore dhe të Mesme të Ulët "Hajrullah Shala" në Akrashticë të Komunës së Vushtrrisë, është promovuar të enjten në ambientet e kësaj shkolle.

Ky libër, që tashmë është në duart e lexuesve, është kontribut i angazhimit të vazhdueshëm të drejtorisë së shkollës, stafit mësimdhënës, Këshillit Drejtues të Shkollës (KDSh) dhe nxënësve, të cilët përmes shkrimeve të tyre shprehën talentin e tyre krijues. "Jam i vetëdijshëm se ky libër, ndonëse modest për nga përmbajtja, prapëseprapë është shumë me vlerë, pikërisht pasi duart dhe mendjet e arta të këtyre fëmijëve të talentuar me shkrimet e tyre nxorën në dritë shumë shkrimtarë fillestarë që premtojnë për të ardhmen", ka thënë drejtori i shkollës, Hajdin Islami.

Ky libër është botuar nga shtëpia botuese "Migros -2". Redaktimin teknik dhe realizimin me kompjuter e ka bërë Hajdin Islami, kopertinën e kanë punuar Elsa Behrami dhe Teuta Plakolli, ndërsa financues është Granti i Bankës Botërore në Kosovë për projektet shkollore.

BE-ja dhe Britania pajtohen për t'i vazhduar bisedimet për Brexit

Bruksel, 20 shtator - Bashkimi Evropian ka thënë se negociatorët britanikë dhe ata të BE-së janë pajtuar për t'i vazhduar diskutimet me qëllim të finalizimit të Brexit-it, apo largimit të Britanisë nga blloku evropian.
Komisioni Evropian ka thënë të premten se bisedimet teknike janë të fokusuara "në konceptet, parimet dhe idetë që i ka çuar përpara Mbretëria e Bashkuar".
Bashkimi Evropian i ka kërkuar Britanisë që të dorëzojë propozime të shkruara se si do të sigurohet lëvizja pa probleme e mallrave në kufirin irlandez kur Irlanda Veriore të largohet nga BE-ja, bashkë me pjesën tjetër të Britanisë.
Komisioni ka thënë se është "thelbësore që të ketë zgjidhje ligjore dhe operacionale" në marrëveshjen për Brexit, ku do të përfshihen kushtet e divorcit.
Ky Komision, po ashtu, ka thënë se BE-ja vazhdon të ketë gatishmëri dhe të jetë e hapur për t'i diskutuar propozimet që përputhen me të gjitha objektivat e ndalesës në kufirin irlandez.
Vendimi për largim të Britanisë nga blloku evropian ka ardhur pasi 52 për qind e votuesve kanë votuar për dalje të Britanisë nga BE-ja kundruall 48 për qind që kanë kundërshtuar atë, në referendumin e mbajtur më 2016.

Pentagoni përgatit planin e përgjigjeve të mundshme ndaj Iranit

Zyrtarë amerikanë kanë thënë se Pentagoni më 20 shtator do ta paraqesë para presidentit Trump një listë të synimeve të mundshme të sulmeve ajrore brenda Iranit, mes përgjigjeve të tjera të mundshme një sulmi ndaj industrisë së naftës në Arabinë Saudite

Uashington, 20 shtator - Zyrtarët e Pentagonit do t'ia paraqesin presidentit amerikan, Donald Trump, një gamë të gjerë opsionesh ushtarake se si t'i përgjigjet SHBA-ja një sulmi ndaj industrisë së naftës në Arabinë Saudite.
Uashingtoni e ka fajësuar Iranin për sulmin.
Ushtria më 20 shtator do ta paraqesë para presidentit Trump një listë të synimeve të mundshme të sulmeve ajrore brenda Iranit, mes përgjigjeve të tjera të mundshme, i thanë agjencisë AP disa zyrtarë amerikanë të afërt me këtë çështje.
Zyrtarët thanë se Pentagoni do të paralajmërojë gjithashtu Trumpin, se veprimi ushtarak kundër Iranit, mund të përshkallëzohet në një konflikt të plotë të armatosur.
Vendimi për hakmarrje ndaj Iranit, mund të varet nga lloji i provave që amerikanët dhe hetuesit sauditë janë në gjendje të ofrojnë, për të mbështetur pretendimet se sulmet u nisën nga Irani.
Disa zyrtarë të administratës, përfshirë sekretarin e Shtetit, Mike Pompeo, kanë pohuar se Teherani ishte pas sulmit.
Pas takimit me aleatët në Arabinë Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, Pompeo tha më 19 shtator se ekzistonte një "konsensus i jashtëzakonshëm në rajon" që Irani kreu sulmin pavarësisht mohimeve të tij.
Irani ka mohuar përfshirjen dhe paralajmëroi Shtetet e Bashkuara se çdo sulm do të çonte në një "luftë gjithëpërfshirëse" me Teheranin.
Me gjithë pretendimet, sekretari Pompeo ka deklaruar se Shtetet e Bashkuara "do të donin një zgjidhje paqësore" ndaj krizës së shkaktuar nga sulmi.
Tensionet në rajon janë rritur, pas sulmit të 14 shtatorit, në një fushë të naftës saudite dhe fabrikës më të madhe në botë të naftës së papërpunuar.
Rebelët Huthi të Jemenit, të mbështetur nga Irani, kishin thënë më herët se ishin mbrapa sulmit përderisa Teherani mohon çdo përfshirje.
Por, Uashingtoni dhe Riadi kanë fajësuar Teheranin për sulmin.
Të mërkurën, Arabia Saudite ka paraqitur disa pjesë të raketave dhe dronëve, që tha se tregojnë se sulmi "është sponsorizuar padyshim nga Irani".

Kryetari i Nju Jorkut heq dorë nga gara për president të SHBA-së

Nju Jork, 20 shtator - Kryetari i Nju-Jorkut, Bill de Blasio ka njoftuar se do të largohet nga gara për president të Shteteve të Bashkuara.
"Mendoj se kam kontribuuar aq sa mundem në rrethin e parë të zgjedhjeve dhe shihet se kjo nuk është koha ime", ka thënë ai gjatë një interviste për MSNBC.
"Kështu që unë do t'i jap fund fushatës sime presidenciale, do të vazhdoj punën si kryetar i Nju Jorkut dhe do të vazhdoj të ngritë zërin për njerëzit e mi", ka thënë ai.
De Blasio, 58-vjeçar, ka nisur fushatën e tij për president në maj të këtij viti.
Zgjedhjet e ardhshme presidenciale në SHBA, mbahen në nëntor të vitit të ardhshëm.

Zgjedhjet parlamentare shkaktojnë ngërç politik në Izrael

Tel-Aviv, 20 shtator - Rezultatet gati përfundimtare të zgjedhjeve parlamentare në Izrael konfirmojnë ngërçin politik, që vë në rrezik qeverisjen e kryeministrit Benjamin Netanyahu, partia e të cilit zuri vendin e dytë.
Para daljes së këtyre rezultateve, partia e djathë Likoud e Netanyahut dhe partia e qendrës Bardheblu e Gantzit ishin kokë më kokë në sondazhin paraprak, në pritje të ndonjë vote më shumë, për të theksuar pozicionin e tyre në bisedimet për formimin e një qeverie të përbashkët kombëtare.
Por rezultatet gati përfundimtare publikuar të premten nga Komisioni zgjedhor, që duhet ende të numërojë edhe 14 qendra votimi, ku janë vënë re parregullsi, janë konform parashikimeve: 33 vende për partinë e Benny Gantz dhe 31 vende për atë të Benjamin Netanyahut, nga 120 të mundshmet në parlament.

Shijo
Pranverën
me...
Jaffa Champion PLUS
A+C+E
Multifrutti
Taste of World Wide Brand!
2L
Jaffa Champion

AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"
Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333

E jashtëzakonshme

Në Ganë përdorin dronët për bujqësi

Fermerët e vegjël në Ganë po përdorin dronët për t'i vëzhguar të mbjellat dhe për spërkatje, në përpjekje për ta rritur rendimentin dhe të ardhurat. Kooperativat e fermerëve po përqafojnë teknologjinë si një hap drejt rritjes së efikasitetit. Megjithatë, disa mendojnë se teknologjia është tepër e shtrenjtë dhe mund t'i dëmtojë fermerët e varfër. Një fermer tregon se në të kaluarën për të bërë këtë punë në një sipërfaqe njëhektarësh duheshin të paktën pesë punëtorë për pesë ditë. Tani këtë gjë po e bën droni.

FOTO E DITES

Peshqit e ngordhur shtrihen në brigjet e liqenit të Koroneia në Greqinë veriore. /AP/

E rrallë

Banorët në panik, macja e zezë lëviz nëpër çatitë e shtëpive

Një mace e zezë u fotografua duke shëtitur në çatitë e shtëpive në një qytet francez. Kjo gjë shkaktoi panik te banorët, të cilët telefonuan menjëherë autoritetet. Dëshmitari Victor Lefranc bëri një postim në "Twitter": "Imagjinoni të pushoni në shtëpi në Armentieres dhe një mace e zezë kalon para dritares". Macja e madhe u kap në rrugët e Armentieres, afër Lilles dhe u qëllua me armë qetësuese nga një veteriner lokal.

BARSOLETA E DITËS

Musa: Qysh je me shnetë?
Isa: Paj... mirë me thanë! Po nganjëherë njëfarë ligshtimi dhe turbullimi e kam.
Musa: Sheqer, a ki?
Isa: Po, kam.
Musa: E yndyrë?!
Isa: Edhe yndyrë kam.
Musa: Sa?
Isa: Edhe nja gjysë thesi sheqer e nja dy taza yndyrë, më duket.

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30

The Angry Birds Movie 2 (3D)

Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 39 min

Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj, etj.

Regjia: Thurop Van Orman

Në ora 17:30

GOOD BOYS

Aventurë/Komedi; 1 orë 29 min

Rolet: Jacob Tremblay, Keith L. Williams, Brady Noon, Molly Gordon, Lil Rel Howery, Will Forte, etj.

Regjia: Gene Stupnitsky

Çdo ditë në ora 19:15

"HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.
Regjia: David Leitchu





Çdo natë në ora 21:30

ONCE UPON A TIME IN HOLLYWOOD

Komedi/Dramë; 2 orë 41 min

Rolet: Leonardo DiCaprio, Brad Pitt, Margot Robbie, Al Pacino, etj.

Regjia: Quentin Tarantino

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Gjatë kësaj dite do të bëni më shumë përpjekje për t'i parë gjërat me optimizëm dhe do të ndiheni më të qetë.



DEMI
Venusi në bashkëpunim me Mërkurin do t'ua ndryshojnë për mirë gjërat sot. Çdo çast do të jetë i kënaqshëm.

BINJAKËT
Gabimi më i vogël që do të bëni sot mund t'ju sjellë pasoja shumë të rënda për të ardhmen. Kini kujdes sot.

GAFORRJA
Do të zgjoheni me më shumë humor gjatë kësaj dite dhe nuk do t'i shihni gjërat me zymtësi.

LUANI
Mirë është që sot të mendoheni mirë për atë që do të bëni në mënyrë që nesër mos t'ju dalë asnjë e papritur ose që ju të mos pendoheni.

VIRGJËRESHA
Pritet një ditë disi e paqëndrueshme sot. Megjithatë, po patët durim, mund edhe t'ju konkretizohen gjërat.

PESHORJA
Optimizmi do t'ju shoqërojë gjatë gjithë kësaj dite dhe nuk do të mërziteni asnjë çast.

AKREPI
Gjatë kësaj dite mund të bëni disa gabime të pafalshme për të cilat do t'i vuani pasojat më pas.



SHIGJETARI
Sot do të kërkoni konsensus në çdo gjë dhe nuk do të inatoseni për asgjë, nga askush.

BRICJAPI
Shumicën e kohës do të jeni me nerva sot dhe as që do t'i dëgjoni ato që do t'ju thonë të tjerët.



UJORI
Fati do t'ju buzëqeshë gjatë kësaj dite dhe nuk do të keni kundërshti për ato që do të bëni.

PESHQIT
Do të jeni shumë të hapur sot dhe të gatshëm për të bërë çdo gjë për të përjetuar emocione pozitive.

Fejohet Arielle Vandenberg

Arielle Vandenberg dhe Matt Cutshall janë fejuar. 32-vjeçarja përmes "Instagram"-it ka treguar se ka marrë propozimin për fejesë. "I fejuari im. Ti je i vetmi. Ai që më bën të buzëqesh", ka shkruar Arielle duke treguar unazën e saj ndërsa Matt e puthi në faqe. "Atij që i besoj me zemër. Ai që më bën të ndjehem kaq e dashur dhe e bukur. Ai që lutet bashkë me mua. Ai që më bën të ndjehem e sigurt. Ai që e desha përgjithmonë. Të dua shumë". Arielle dhe Matt ishin miq disa vjet më parë, përpara se ta konfirmonin se ishin zyrtarisht çift në vitin 2017.

Kenya Moore ndahet nga bashkëshorti

Kenya Moore dhe Marc Daly kanë vendosur t'i japin fund martesës së tyre. 48-vjeçarja ka dhënë një deklaratë për "People" duke treguar se ajo dhe burri i saj 49-vjeçar, janë ndarë pas dy vitesh martesë. "Me trishtim të thellë informoj fansat e mi se po shkurorëzohem nga burri im Marc Daly. Për shkak të rrethanave të fundit dhe të vazhdueshme, nuk mund të vazhdoj më martesës. Brenga dhe përqendrimi im i vetëm është dhe do të jetë gjithmonë vajza ime. Kërkoj që privatësia jonë të respektohet", ka thënë ajo. Kenya dhe Mark mirëpriten vajzën e tyre Brooklyn, në nëntor.

Bebe Rexha publikon këngë të re

Bebe Rexha ka publikuar një këngë të re. Këngëtarja 30-vjeçare ka publikuar këngën "You Can't Stop the Girl". Në fund të muajit të kaluar për nder të ditëlindjes së 30-të, artistja me prejardhje shqiptare ndau një fotografi në të brendshme menjëherë pasi publikoi "Not 20 Anymore".

Kylie Jenner mohon ndarjen nga Travis Scott



Kylie Jenner i është përgjigjur thashethemeve se ajo dhe Travis Scott janë ndarë. Fansat filluan të mendojnë se diçka kishte ndodhur mes çiftit, kur Kylie postoi në rrjetet sociale një fotografi të saj. Në fotot e mëparshme, në sfond gjithmonë ka pasur një foto të saj me Travis. Por, Kylie ka postuar një fotografi në "Instagram" për të mbyllur të gjitha spekulimet për ndarje. Ajo postoi një fotografi të saj me reperin dhe vajzën e tyre Stormi në një kopsht zoologjik si dhe disa vepra arti. Kjo nënkupton që ata janë ende bashkë.

TERESE BACKLUND, FINLANDEZJA E MAHNITUR ME DASHURINË E KOSOVARËVE

Kosova, tashmë si një vend i lirë çdo vit pret turistë nga e gjithë bota. Ata vijnë për ta shuar kureshtjen e tyre për shtetin e ri me shumë bukuri. Dikush vjen dhe viziton Kalanë e Prizrenit, të tjerët malet e mrekullueshme të Pejës, por Terese Backlund ka ardhur për një arsye tjetër: ajo po qëndron në Kosovë për të përfunduar një praktikë në një organizatë në vendin tonë.

Për eksperiencën e saj në Kosovë, gjithçka që i ka bërë përshtypje për vendin tonë, ajo ka treguar qartë, thjeshtë dhe shkurt në intervistën për KulPlus. Terese Backlund është 28 vjeçe dhe studion në Finlandë për Politikat Sociale.

KultPlus: Cila ishte përvoja juaj në ditën e parë në Kosovë?

Terese Backlund: Dita ime e parë ishte një surprizë pozitive. Unë kurrë më parë nuk kam qenë në Kosovë dhe s'mund ta besoja sa moderne dhe e zhvilluar është Prishtina. Menjëherë fillova ta dua apartamentin dhe hapësirën ku unë jetoj, në qytet ndihem e sigurt dhe e mirëpritur. Meqë vij nga një qytet i vogël në Finlandë, ishte shumë mirë të shoh se edhe Prishtina nuk është shumë e madhe dhe unë mund të ndihem shumë shpejt si në shtëpinë time.

KultPlus: Si ishte java juaj e parë?

Terese Backlund: Stafi i organizatës ku unë jam duke e bërë punën praktike në Prishtinë më ka ndihmuar lidhur me çdo gjë. Para se të vija në Kosovë unë kam marrë informacione rreth Kosovës, rreth vendit të punës, apartamentit, si të qarkulloj në qytet… Isha shumë mirë e përgatitur, dhe kur takova kolegët e mi këtu, ata më shëtitën nëpër qytet dhe unë u ndjeva më të vërtetë shumë e mirëpritur, ata ishin shumë të sjellshëm dhe ndihmues. Duke i falënderuar ata, unë mësova shpejt si ta përdori trafikun urban, ku të blej gjëra ushqimore, dhe u regjistrova në fitnes gjithashtu. Më janë dashur 2 javë në maksimum të adaptohem dhe të ndihem si në shtëpinë time, duke i falënderuar miqtë e mi dhe të gjithë njerëzit e tjerë që më ndihmuan kudo. Kjo është përshtypja ime e parë dhe më e madhja në Kosovë; sa të shoqërueshëm dhe ndihmues janë njerëzit në këtë vend.

KultPlus: Çfarë mendoni rreth ushqimit, cili është ushqimi juaj i preferuar këtu?

Terese Backlund: Kjo është njëra ndër gjërat më të mira në Prishtinë, ushqimi dhe mundësia për të zgjedhur ushqime të ndryshme me shije të llojllojshme. Qyteti është i mbushur me restaurante dhe kafene të mira dhe me njerëz që qëndrojnë jashtë, dhe këtë e dua shumë sa i takon kulturës këtu, që njerëzit takohen shpesh për të pirë një ekspreso dhe qëndrojnë bashkë. Të shkosh dhe të hash ushqim tradicional shqiptar, kjo është gjëja më e mirë. Pikërisht se e dua ushqimin tradicional shqiptar unë shkoj shpesh në "Tiffanys" (restaurant me ushqime tradicionale) i cili është vendi im i preferuar këtu kur bëhet fjalë për gastronomi. Unë vizitova edhe miqtë e mi që janë me origjinë nga Kosova dhe që kanë ardhur në Kosovë për pushime verore. Unë takova edhe të afërmit e tyre këtu në Kosovë dhe më pëlqeu shumë kur ne u ulëm për të pirë kafe turke dhe për të ngrënë ëmbëlsira. Bakllava dhe bombica tani janë ëmbëlsirat e mia të preferuara që i shijova këtë verë këtu. Kjo është njëra ndër gjërat më mbresëlënëse që kam për t'i mbajtur në mend nga vera këtu; sa miqësor janë njerëzit këtu, dhe për ftesa që ua bëjnë të tjerëve për t'u ulur në shtëpitë e tyre, biseduar dhe pirë kafe së bashku.

KultPlus: Në anën tjetër, si do t'i përshkruani qytetet në Kosovë, në veçanti nga aspekti gjeografik?

Terese Backlund: E dua Prishtinën. Ndihem e sigurt dhe e lumtur këtu, gjithmonë

ke çfarë të bësh këtu. Ju mund të dilni për darkë, apo për të pirë ndonjë kafe në shumë vende të mira këtu. Fitneset janë shumë të mira, "Albi Mall" , Katedralja e "Nënës Terezë" që është ndër pikat turistike më të pëlqyera nga unë sepse është shumë e bukur. Në Prishtinë është shumë lehtë të sillesh nëpër qytet meqë nuk është qytet shumë i madh.

Unë kam qenë gjithashtu edhe në Ferizaj, Prizren, Mitrovicë, Vushtrri dhe Gjakovë. Unë s'kam qëndruar shumë nëpër ato qytete, për aq kohë sa kam qëndruar Prizreni është shumë i bukur. Të ecësh rrugës për në "Kala" ju mund të keni mundësi të shihni pamje të mrekullueshme nga lart qytetit. Kur e vizitova Mitrovicën, u takova me disa miq dhe ata më shëtitën nëpër qytet, unë isha edhe në shtëpitë e tyre. Ndryshe nga Prishtina, ishte një ndjenjë tjetër të isha në atë qytet. Sidomos kur pashë urën dhe pengesat. Si një e huaj unë vetëm mund të dëgjoj dhe lexoj për historinë e Kosovës, por të shohësh vet zonën ku ende mund të ketë tensione ishte një mundësi e mirë për ta parë realitetin.

Unë kam vizituar edhe Junikun meqë organizata ku unë punoj ka një kamp të të rinjve atje. Ishte një eksperiencë e mirë për mua që të jem poshtë maleve dhe të organizojmë një kamp së bashku. Është vështirë t'i krahasosh qytetet mes vete sepse secili qytet e ka hijeshinë e vet. Ju mund të shihni natyrë të bukur me male dhe lumenj por ju mund të shihni edhe xhamia dhe monumente historike. Sidoqoftë mua me të vërtetë më pëlqejnë ato qytete dhe për mua ishte shumë argëtuese të takoj njerëz të ndryshëm dhe të vizitoj vende të ndryshme këtu.

KultPlus: Cfarë mendoni për mënyrën e të jetuarit këtu në të gjitha aspektet, a jemi ne "Europianët e Rinj" siç mendojmë se jemi?

Terese Backlund: Unë nuk mund të flas për të gjithë vendin meqë pjesën më të madhe të verës e kam kaluar në Prishtinë. Të rinjtë që i kam takuar këtu nuk duken apo nuk veprojnë shumë ndryshe nga, ta zëmë, të rinjtë në Suedi ose Finlandë. Qyteti është i zhvilluar dhe ju mund të bëni shumë gjëra të ngjashme si në çdo vend të Europës kur është fjala tek shoppingu, kinemaja, të shkuarit në fitnes etj. Ne jemi duke i përdorur të njëjtat aplikacione, rrjetet sociale, shikojmë të njëjtat filma, kështu unë nuk mund të shoh dallim të madh mes të rinjve që jetojnë në Prishtinë dhe vendit tim kur është puna tek mënyra e të jetuarit në aspektin shoqëror. Sidoqoftë, unë mund ta shoh dallimin kur vije puna tek edukimi. Unë vetë jam studente dhe kur dëgjoj se sa vështirë është të gjesh një punë këtu pasi të diplomosh atëherë unë e shoh dallimin midis të njëjtëve njerëz, të së njëjtës moshë, të të njëjtit nivel të shkollimit. Natyrisht që këtu ka ndryshim dhe shpresoj të jetë edhe më lehtë në të ardhmen sepse këtu ka shumë të rinj të zgjuar, punëtorë, dhe të motivuar që duan të shkollohen dhe të punësohen këtu.

KultPlus: Çka do t'ju thuash miqve të tu në Finlandë për njerëzit e Kosovës?

Terese Backlund: Kjo është gjëja e parë që do t'ju tregoj të tjerëve kur të më pyesin për Kosovën. Unë gjithmonë do të ju them "Kosova është e mbushur me njerëz të sjellshëm, ndihmues dhe që pranojnë njëri-tjetrin, ata dinë si ta kenë me prioritet edhe jetën familjare". Askush nuk po më trajton ndryshe nga të tjerët apo në ndonjë mënyrë të keqe. Unë më të vërtetë po ndihem sikur të gjithë njerëzit që i takoj janë të zgjuar dhe shumë të sjellshëm. Unë këtë nuk e dija para se të vija këtu dhe kam menduar se do ta kem shumë të vështirë të adaptohem me njerëzit dhe me jetën këtu por tani po e shoh se kam qenë gabim. Me të vërtetë do të më mungojnë njerëzit këtu dhe kur të kthehem në vendin tim, unë do të provoj me gjithë zemër që të vij dhe t'i vizitoj miqtë e mi të ri në Kosovë.

KultPlus: Në fund, duke ju falënderuar për kohën tuaj, a ka ndonjë gjë që do të dëshironit ta ndryshonit në shoqërinë tonë, nëse po, a mund të na tregoni çfarë?

Terese Backlund: Ky është një vend që ka pasur luftë vetëm njëzet vite më parë, ju po zhvilloheni dhe po përpiqeni të përmirësoheni gjithmonë. Natyrisht, duhen shumë ndryshime për ta ndërtuar një shoqëri dhe një vend. Kështu, kemi shumë çështje që duhet diskutuar, si barazia gjinore, të drejtat e njeriut, ekonomia, sistemi arsimor, etj. Por unë shpresoj që procesi i të ndërtuarit një shtet të fortë dhe të pavarur do të jetë i suksesshëm. Jam shumë falënderuese për vizitën time këtë verë këtu dhe për të gjithë njerëzit që i kam takuar.

Personalisht, kam mësuar në Kosovë se njerëzit tregojnë shumë respekt për të tjerët. Edhe në vendin tim tregojmë respekt për njëri-tjetrin por këtu ju mund të qëndroni dhe të keni një shtrëngim duarsh kur ju takoni ndonjë person dhe ka shumë shprehje të këndshme - "Përshëndetje, si jeni a jeni mirë, më vjen mirë që u takuam" në vend të vetëm një "Hello". Më pëlqen shumë këtu të shoh se si njerëzit e trajtojnë njëri-tjetrin dhe kjo flet vetëm për sjellje të mira. Unë gjithashtu kam mësuar sesi të ndash kohë për tu ulur dhe pirë një ekspreso bashkë me shokë dhe shoqe dhe jo të jem gjithmonë në nxitim dhe në mendim se çfarë duhet të bëj gjatë gjithë kohës.

(Qendrim Badalli/ KultPlus.com)

Dabiqaj: Feronikeli shpejt do të jetë aty ku e ka vendin

Futbollisti i Feronikelit, Albert Dabiqaj, është optimist se skuadra e tij do të jetë shumë shpejt aty ku e ka vendin, pra në pozitën e parë të Superligës. "Është e vërtetë se kemi bërë disa lëshime të vogla në dy ndeshje të këtij edicioni. Fillimi ishte pak i lodhur nga ne si pasojë e pjesëmarrjes në ndeshjet e Evropës, por kjo nuk është për t'u shqetësuar, sepse skuadra është rikthyer në formë dhe dallimi mes skuadrave kryesuese është e vogël. Shpejt do të jemi aty ku e kemi vendin", ka thënë Dabiqaj

EPOKA E RE — Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Kampioni i Kosovës në futboll dhe fituesi i Kupës, Feronikeli, nuk e nisi mirë edicionin 2019/2020 në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, pasi nga pesë ndeshje të zhvilluara ka arritur tri fitore dhe dy humbje. I kontaktuar nga redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re", mesfushori Albert Dabiqaj ka treguar arsyet e fillimit jo të mirë të skuadrës nga Drenasi, por për të rëndësi të madhe ka fakti se dallimi mes skuadrave të para është i vogël. "Është e vërtetë se kemi bërë disa lëshime të vogla në dy ndeshje të këtij edicioni. Fillimi ishte pak i lodhur nga ne si pasojë e pjesëmarrjes në ndeshjet e Evropës, por kjo nuk është për t'u shqetësuar, sepse skuadra është rikthyer në formë dhe dallimi mes skuadrave kryesuese është i vogël. Shpejt do të jemi aty ku e kemi vendin", ka thënë Dabiqaj.

Ndeshjen e radhës ndaj Dukagjinit, Feronikeli e zhvillon të dielën në Klinë. Mesfushori Dabiqaj ka thënë se, pavarësisht prej rezultateve jo të mira, skuadra kundërshtare e "Niklit" ka potencial të mjaftueshëm që t'u nxjerrë telashe të gjitha skuadrave të tjera në elitën e futbollit të Kosovës. "Dukagjini ka pasur ngecje në këtë fillim të kampionatit, por kjo nuk do të thotë se ne e kemi të garantuar fitoren përballë tyre. Ata kanë një skuadër me të vërtetë shumë cilësore dhe që mund t'i shkaktojë probleme secilit ekipit në Superligë", ka shtuar ai.

Ky kampionat në pesë xhirot e para ka qenë mjaft interesant dhe befasitë nuk kanë munguar, derisa për ish-mesfushorin e Besës së Pejës lëvdatat më të mëdha i meriton skuadra e Ballkanit nga Suhareka. "Ajo që mund të them është se në xhirot e zhvilluara për të mirë më ka befasuar Ballkani. Ky klub ka dëshmuar se ka një ekip cilësor dhe mund të arrijë rezultate të mira në këtë kampionat, kurse skuadrat e tjera renditen aty ku edhe e meritojnë në bazë të asaj çka kanë paraqitur në fushë", ka shtuar Dabiqaj.

IPKO SUPERLIGA

Të dielën takohen:
15:00 Drita - Trepça '89
15:00 Dukagjini - Feronikeli
20:00 Prishtina - Gjilani

Të hënën takohen:
15:00 Ferizaj - Drenica
15:00 Ballkani - Vushtrria
15:00 Flamurtari - Llapi

SHKURT

Kosova U15 arrin fitore bindëse ndaj Rumanisë

Kosova U15 në konkurrencën e meshkujve e ka nisur me fitore bindëse turneun në Maqedoninë Veriore. "Dardanët" e rinj triumfuan ndaj Rumanisë me rezultat 75:49. Kosova dominoi nga fillimi deri në fund, duke shënuar fitore të merituar, kurse Eliot Peci shënoi 18 pikë, derisa Rron Dahsyla realizoi 15. Ndërkohë, Kosova U15 te femrat ka pësuar nga Rumania 32:71.

Berisha: Lazio humbi për shkak të penalltisë dhe atmosferës në stadium

Ylli i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Valon Berisha, ishte titullar në ndeshjen që Lazio e humbi në Ligën e Evropës nga Cluji (2-1). Berisha ka shprehur mendimin se goli nga penalltia dhe atmosfera në stadium ndikuan në humbjen e skuadrës italiane. "Kjo ishte një ndeshje shumë e rëndësishme për ne. Në pjesën e parë luajtëm mirë, shënuam gol dhe kaluam në epërsi. Pastaj kemi pësuar gol nga një penallti e dyshimtë, kurse në pjesën e dytë kishim telashe edhe për shkak të atmosferës në stadium. Pasi pësuam golin e dytë, të gjithë e dinim se çfarë ndodhi", ka thënë Berisha.

Mourinho: Reali ka trajner

Jose Mourinho shikohet si kandidati kryesor për ta marrë postin e Zinedine Zidanes te Real Madridi. Në lidhje me këto zhvillime trajneri portugez është intervistuar nga një medie spanjolle, për të cilën ai theksoi se nuk mund të drejtojë një ekip që aktualisht e ka një trajner. "Të flitet për emrin tim është diçka që nuk më pëlqen. Nuk do të më pëlqente ta stërvitja Real Madridin sepse aktualisht e ka një trajner", ka thënë Mourinho.

Peja rikthehet në Ligën Ballkanike

KB Peja është riorganizuar dhe fitoi të drejtën të garojë sërish në Superligën e Kosovës në basketboll, derisa klubit iu fshinë disi edhe borxhet ndaj Federatës së Basketbollit të Kosovës, si dhe skuadrës iu hoq dënimi nga FIBA. Skuadra pejane është përforcuar me shumë basketbollistë, përfshirë këtu edhe Drilon Hajrizin dhe është gati për sezonin e ri. Por, përveç në kampionatin e Kosovës, Peja do të bëjë gara edhe në ligën rajonale të basketbollit, Liga Ballkanike. Lajmi është konfirmuar edhe nga Liga Ballkanike, që e ka përfshirë skuadrën në edicionin e sivjetmë, aty ku do të jetë edhe skuadra e Rahovecit.

Nëse Fenerbahçe e shet Muriqin, 15 % e shumës i takon Rizesporit

STAMBOLL, 20 SHTATOR - Presidenti i Rizesporit, Hasan Kartal, ka bërë me dije se ekipi i tij do të përfitojë 15 % të vlerës nëse Fenerbahçe shet sulmuesin Vedat Muriqi në ekipet elitare në Evropë. "Ai erdhi te ne dhe përfaqësoi Rizesporin në mënyrën më të mirë. Tani po djersin për suksesin e Fenerbahçes. E besoj se Vedati do të jetë i suksesshëm. Jemi shumë të lumtur t'i shohim ofertat që vijnë për të. Ashtu siç u përmend, nëse transferohet në Evropë nga Fenerbahçe, atëherë klubi ynë do të përfitojë 15 % nga shitja e tij. Kjo na bën të lumtur, por dëshira ime është që t'ia kujtojmë emrin te Fenerbahçe", ka thënë Hasan Kartal.

Lekaj: Më kënaqësi pranova ftesën e Kosovës

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Marijeta Lekaj është një prej hendbollisteve të reja që janë bashkuar me Kosovën për ndeshjet me Slloveninë (26 shtator) dhe Gjermaninë (29 shtator). Lekaj luan në Kroaci, ndërsa ka premtuar ta japë maksimumin për ta ndihmuar Kosovën. "Po ndihem shkëlqyeshëm pasi do të luaj për vendin tim dhe jam shumë e lumtur që më kanë ftuar. FHK-ja më ka kontaktuar përmes federatës kroate dhe unë kam pranuar ftesën menjëherë me shumë kënaqësi", ka thënë Lekaj. "Aktualisht luaj te klubi Murvica nga Crikvenica. Kam luajtur më parë në tri klube të tjera, kurse aktualisht jam në ligën elitare të Kroacisë. Kam luajtur për të gjitha grupmoshat në regjionin tim, kam shumë gara pas vetes. Luaj në të gjitha pozitat e jashtme, para së gjithash qendër", ka shtuar Lekaj.

Mustafi: Nuk dua 'luftë' me Arsenalin

LONDËR, 20 SHTATOR - Mbrojtësi shqiptar Shkodran Mustafi, pas shumë spekulimeve gjatë afatit kalimtar të verës lidhur me largimin nga "Emirates Stadium", ka thënë se nuk do të fillojë një "luftë" me skuadrën e Arsenalit për të ardhmen e tij. Trajneri Unai Emery kishte paralajmëruar Mustafin të gjejë një ekip të ri gjatë verës, por ai nuk u largua dhe tash trajneri Emery ka paralajmëruar se Mustafi mund të ketë të ardhme në klub.

Ish-reprezentuesi i Gjermanisë bëri paraqitjen e tij të parë këtë sezon duke luajtur tërë ndeshjen në fitoren 3-0 ndaj Eintracht Frankfurtit në Ligën e Evropës. "Kurrë nuk kam qenë në mesin e atyre që fillojnë një luftë sepse diçka nuk funksionon", ka thënë Mustafi. "Gjithmonë kam thënë, nëse është e mundur jam i gatshëm ta bëjë hapin tjetër. Nëse jo, do të vazhdoj të luaj futbollin tim. Babai im, që është edhe menaxheri im, ka biseduar me klubin. Jam futbollist i Arsenalit dhe kam edhe dy vjet në kontratën time", ka shtuar Mustafi.

27-vjeçari ka qenë pjesë edhe e Evertonit, Sampdorias dhe Valencias. Ndërsa për Kombëtaren e Gjermanisë është paraqitur në 20 ndeshje dhe ka shënuar dy gola, kurse arriti që në vitin 2014 të shpallet kampion i botës.

Kubica: Në fund të sezonit do të largohem nga Formula 1

SOUTH SEA, 20 SHTATOR - Rikthimi i tij në Formula 1 u prit me shumë bujë, por pas vetëm një sezoni Robert Kubica do të largohet nga makina Williams. Piloti polak gjatë konferencës për shtyp në Singapor, ku të dielën zhvillohet gara e radhës e botërorit, dha lajmin e divorcit nga makina britanike. "Nuk do të vazhdoj me Williamsin sezonin tjetër. Do të ndalem dhe do të shoh për mundësi të tjera që do të kem, në disiplina të tjera. Mu desh shumë energji e vullnet që të rikthehesha në Formula 1 dhe objektivi im ishte të qëndroja, por jo me çdo kusht", ka thënë Kubica. "Dua të bëj diçka që të më japë kënaqësinë e garës dhe ky sezon ishte shumë i vështirë si nga ana e rezultateve ashtu dhe nga ana fizike. Falënderoj skuadrën për mundësinë që më dha, por mendoj se mora vendimin e duhur", ka shtuar Kubica, që u rikthye në Formula 1 pas 7 vjetësh, por pa sukses.

SHKURT

Shkupi prezanton trajnerin Qatip Osmani

FC Shkupi e ka prezantuar trajnerin e ri Qatip Osmani. Ish-trajneri i Shkëndijës ka nënshkruar kontratë me skuadrën e re deri në vitin 2021. "Një prej trajnerëve më të trofeshëm në vend, merr drejtimin e skuadrës tonë dhe tashmë ka hedhur firmën në kontratë, e cila do ta mbajë lidhur me 'bardheblutë' deri në vitin 2021. Osmani në këtë post vjen si zëvendësues i Bulent Akinit, ndërsa për ndihmës do ta ketë Bashkim Livorekën. Qatip Osmani është njohës shumë i mirë i futbollit vendor dhe praktikon më shumë lojë sulmuese. Ai sezonet e fundit ishte pjesë e Shkëndijës, me të cilët në dy vjetët e fundit fitoi dy tituj kampionë dhe një trofe të Kupës", thuhet në njoftimin e FC Shkupi.

Osmani gjatë karrierës së tij si trajner ka udhëhequr edhe ekipin e Renovës, ndërsa ka të fituar gjithsej tre tituj kampionë, një trofe të Kupës dhe një Superkupë. Ndërsa është trajneri i tretë që ulet në stolin e Shkupit në këtë sezon, pasi para tij kishim dy trajnerë turq, Umit Karanin dhe Bulent Akinin. Osmani debuton të mërkurën në ndeshjen e Kupës me FK Sileksin, ndërsa në ndeshjen me Akademinë Pandevin ekipi do të udhëhiqet nga Orhan Abdi.

Barça në janar largon Rakitiqin dhe Vidalin

Mesfushorët Ivan Rakitiq dhe Arturo Vidal do të largohen nga skuadra e Barcelonës gjatë afatit kalimtar të janarit. Mediumet spanjolle kanë njoftuar të premten se drejtuesit e klubit tashmë kanë marrë vendim për shitjen e tyre dhe i kanë futur në listën e largimeve. Rakitiqi ka regjistruar vetëm 94 minuta lojë këtë edicion në të gjitha ndeshjet dhe me Barcelonën ka kontratë deri në vitin 2021. Ndërkohë, Vidali ka kontratë deri në vitin 2021 me Barçën, kurse këtë edicion ka vetëm 41 minuta lojë në La Liga.

Pensionohet Berbatovi

Një tjetër sulmues që ka shkruar histori në dy dekadat e fundit i jep fund karrierës futbollistike. Dimitar Berbatov ka lajmëruar se ka vendosur t'i varë këpucët në gozhdë një vit e gjysmë pas ndeshjes së fundit zyrtare të luajtur prej tij. Përvoja e fundit e bullgarit 38-vjeçar ishte në Indi me skuadrën e Kerala Blasters. Lojtari i lindur në vitin 1981 nuk luan në Evropë që nga viti 2016, kur vishte fanellën e Paokut të Selanikut. Berbatovi ka luajtur për CSKA Sofje, Bayer Leverkusen, Tottenham Hotspur, Manchester United, Fulham dhe Monaco.

Unitedi planifikon rinovimin e kontratës me Pogban

Manchester Unitedi e ka ndërmend ta rinovojë kontratën e Paul Pogbas për ta larguar interesimin e Real Madridit. Unitedi refuzoi të gjitha ofertat për lojtarin në afatin kalimtar të verës, kurse tash synon që ta "blindojë" përfundimisht. Kontrata e reprezentuesit francez me skuadrën nga "Old Trafford" skadon në qershor 2021 dhe mesfushori mund të largohej falas pas përfundimit të kontratës ose vlerësimi i transferimit të tij mund të zvogëlohej ndjeshëm verën e ardhshme, gjithnjë nëse nuk arrihet një marrëveshje e re.

Irani merr vendimin historik, lejon hyrjen e femrave në stadium

Irani merr vendimin historik për lejimin femrave në stadium për të ndjekur ndeshjet e futbollit. Nuk është ende një vendim me efekt të përgjithshëm, por gjithsesi mbetet shumë i rëndësishëm, 40 vite pas ligjit absurd që i pengonte gratë iraniane të ndiqnin si spektatore lojën e bukur të futbollit. Stadiumet e futbollit në Iran do t'i hapin dyert për femrat vetën në sfidat e kombëtares. Lajmi u dha nga ministri i Sportit, Masoud Soltanifar, i cili shpjegoi se më stadiumin Azadi të Teheranit, ku Irani luan pjesë më të madhe të ndeshjeve kualifikuese të Botërorit të vitit 2022, janë ndërtuar hyrje dhe tualete të ndara. Përballja me Kamboxhian, e programuar për t'u zhvilluar më 10 tetor, do të shënojë një kthesë të madhe.

Autor: GAZMEND MORINA

I VË TELA NUSES; STOLIS NUSEN ME TELA
FEMRA LUFTËTARE QË NUK MARTOHEJ (mit. greke)
DYPALËSH
BIMË E VISEVE TROPIKALE (shq.)
DEM, TER
EPOKA E RE
AFTËSI E PAGIMIT (treg.)
PUNËTORI I TEATRIT TË KUKULLAVE
LËNDË KRISTALORE SHUMË E ËMBËL
ISH SHEFI I CIA-së XHORXH ..... / NAIM ISMAILI

FLETË LETRE PËR DUHAN
PELLG A REZERVUAR I HAPËT PËR TË GRUMBULL-UAR UJË

MODELJA ÇUNMULAJ
MËNYRË ARTIFICIALE E EPSHIT (shq.) / NEVOJË E THEKSUAR PËR NGRËNIE

FUTBOLLISTI ALTIN ....
QË TAKOHET SHUMË RRALLË; E VETME
SHKRETËTIRA MË E THATË NË BOTË

THIRRJE E MYEZINIT
RI PESHOVA (bised.) / ARDHJA NË JETË E NJË FOSHNJE

ABSOLUT, AUTOKRATIK / MBRET ILIR
BASHKËT. / VLERË, DOBI

SHKENCA MBI MORALIN

LLOJ HELMI LUFTE
QË TË FORCON E TË JEP FUQI (PËR PIJE) / BASHKËT.

EPOKA E RE
LUFTËTAR I VJETËR E ME PËRVOJË
AKTORE E JONA (I. C.)
SHKËMB I PËRBËRË PREJ RËRE
100 M^2
INICIATIVAT
EPOKA E RE
PËRFUNDIM (shq.)
ZANORE / ANKESA
DOKTOR (shk.) / LLOJ VETURE FRANCEZE
KËNGËTARJA VALENTINA / KRYETAR I NJË ÇETE

I SHKRETUAR; I SHKRETË (Për vende)
KËNGËTARJA NË FOTO SONI .....
KUDRET ISAI / NJË E PANJOHUR NË MATEMATIKË
EDI MARFI / KITARISTI I FAMSHËM KLEPTON

THESARI (Lat.)
DY BASHKË-TINGËLLORE
AJKA E QUMËSHTIT / TON, NATRIUM
SHKRONJË GREKE / BENDI MUZIKOR "…. MAIDEN"

DISIPLINË SPORTIVE / AKTORI FRANCEZ JEAN …. (shqip.)
VEPRA E KRYER, PUNA / JON ME NGARKESË NEGATIVE
PJESË E ILIRISË / QË KA NATYRËN E SENDIT, LËNDOR
SHTET NË EVROPË (pashq.)
PUSULLA

HUMANISTI BIÇIKEMI
SHTERPE / KLUB FUTBOLLI NË FRANCË

RADIUM, REOMIR
SHTAZORE / AKTORI KUSHTRIM
ZAKONET / PAJISJE QË LËSHON TINGUJ TË MPREHTË (shq.)

AGIM CANA
RRITJA E SASISË / KORIJE
NJERI (turq.) / BOTIM I PËRDITSHËM QË PËRMBAN LAJME
TITAN / VRANËSIRË

OJNA
DY ZANORE / UNIVERSITY RHODE ISLAND
FUTBOLLISTI DIEGO ..... (Atl. Madrid) / DJALI KUNDREJT PRINDËRVE (pashq.)
ZHANËR I MUZIKËS / FISHEKZJARRI QË HIDHET LART PËR TË DHËNË SHENJA

EPOKA E RE
ATDHETARI ..... ALIU / HEROI ZEJNULLAHU (shq.)
VENDËS / LLOJ PIJE ALKOOLIKE (shq.)
AKTORJA AMERIKANE OLSTEAD / SILIC

LAJM; NJOFTIM (turq.)
AKTORJA DHE MODELJA … HURLEY
LULE NË TRAJTË VILEJE (shq.) / FUTBOLLISTI ITALIAN FRANÇESKO
ISMET TOTO / KËNGËTARJA SOPJANI

PAGJAKËSI
IRNOSET (bised.) / QELESHE
MARKË E VESHJEVE SPORTIVE (origj.) / LËNDË MËSIMORE
ZANORE / AKTORI FRANCEZ …. DELON

KILOGRAM (krah.)
POLICIA E KOSOVËS / ZANORE
NJË PLANET / AKTORI HOLLIVUDIAN BRED …
KËNGËTARJA … ZARI / MIK (FR.)
FILM I YNI "… ISHIN KATËR"

ZANORE
ALESANDRO NESTA
LARGNDIJIM / DY BASHKË-TINGËLLORE
PRIJËS I HUNËVE / ARIAN MALIQI

MBARËSIA
AXHAMI / EVERTON
TERRITOR I IMAMIT (sh.shq.) / ZANORE

BASHKIM QELIZASH TË NJËLLOJTA
E VURA NË SITË
PËREMËR PRONOR
TENISTJA KURNIKOVA

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NJOFTIM

Të gjithë investitorët potencial që planifikojnë të ofertojnë në

Shitjen 50

të aseteve të ndërmarrjeve në Likuidim, njoftohen se:

Dita e dorëzimit dhe hapja e ofertave është: **e hënë 23 shtator 2019**, prej orës **10:00 - 12:00**,

në **"Sallën e konferencave - Hotel Grand" , Prishtinë**.

*** Shënim: Njësia në vijim është tërhequr nga Shitja e aseteve 50:**
Njësia nr.44: Toka në Radoniq

Si duhet të përgatitet oferta:

OFERTA E JUAJ DUHET TË PËRMBAJ 3 PLIKO (ZARFE).

Të gjitha dokumentet e ofertës duhet të vendosen në një **pliko (zarf)** të madh e të mbyllur – shih më poshtë: **ZARFI 3**
Brenda këtij zarfi (ZARFI 3), ju duhet të vendosni dy zarfe të tjera të mbyllura: ZARFI 1 dhe ZARFI 2

ZARFI 3

OFERTA PËR SHITJEN E ASETEVE NR.....
Numri i njësisë: .....
Përshkrimi i njësisë: .....

ZARFI 1

INFORMATA SHTESË PËR OFERTËN
(Shitja e Aseteve nr. ....)
Numri i njësisë: .....
Përshkrimi i njësisë: .....

ZARFI 2

ÇMIMI I OFERTËS
(Shitja e Aseteve nr. ....)
Numri i njësisë: .....
Përshkrimi i njësisë: .....

Dokumentet në vijim duhet të vendosen brenda zarfit
"Informata shtesë për ofertën"

1. Dokumentin e mëposhtëm në lidhje me ofertuesin ose personin që nënshkruan ofertën

Kopja e letërnjoftimit apo pasaportës valide

2. Dëshmi e cila tregon që tarifa për dorëzimin e ofertës është transferuar në llogarinë e AKP-së.

Tarifa për dorëzimin e ofertës prej 300 € (treqind Euro)	Numri i llogarisë: **1000510000000173**

3. Dëshmi e cila tregon që depozita e ofertës është transferuar në llogarinë përkatëse të AKP-së në BQK.

Depozita e ofertës	Numri i llogarisë: **1000510000000076**

SHTOJCA B
FORMULARI PËR DORËZIMIN E OFERTËS
- PASQYRA E ÇMIMIT -

SHAL/Vala numër: SHA nr. XX
Numri i njësisë dhe emrii asetit/subjektit të ri për të cilin ofertoni: Njësia nr. XX
Emri i njësisë

ÇMIMI I OFERTËS
shëno çmimin e ofertës që ju synoni të paguani për asetin/subjektin e ri në shifra dhe fjalë:

€ ___.100.000.00
NË FJALË: [Njëqindmijë euro]

NË RAST SE OFERTUESI NUK PARAQET ÇMIMIN E OFERTËS EDHE ME FJALË EDHE ME SHIFRA, OFERTA E TU DO TË DISKUALIFIKOHET

SHËNIME:
- në rast të gjarëdo mospërputhje, në mes të shumës së paraqitur me shkronja dhe shumës së paraqitur me shifra do të mbizotëroj shuma e paraqitur në shkronja dhe do të trajtohet si çmimi i ofertës.
- në rast se shuma e paraqitur me shifra dhe shuma e paraqitur me fjalë janë të palexueshme dhe/ose të pakuptueshme, oferta e ofertuesit do të diskualifikohet.
- nuk lejohet asnjë ndryshim/përmirësim i çmimit të ofertës. agencia do të shpall si pavlefshme ofertën e dorëzuar e cila ka ndryshim/përmirësim të çmimit të ofertës sipas nenit 11.1 të kësaj rregulloreje.

INFORMATAT E KONTAKTIT TË OFERTUESIT
Emri i Ofertuesit: Filan Fistekë
(për person fizik - Emri i Mbiemri / për subjekt juridik - Emri i subjektit juridik)
Adresa: këtu shënoni adresën e saktë
Nr. tel: +383 XX XX XX XX Email-i: këtu shënoni adresën tuaj elektronike
Nr. Personal/Nr. i regjistrimit të biznesit: XX XX XX XX XX

DEKLARATË
Përmes kësaj deklarate unë pohoj se i kam lexuar dhe kuptuar Rregullat e Tenderit (RT) dhe garantoj se i plotësoj dhe i nënshtrohem kushteve të cekura në RT dhe nuk jam ofertues me ndalesë sipas Nenit 3 të RT-it;
Emri & Mbiemri: Filan Fistekë Data: XX XX XX
Nënshkrimi: këtu vendosni nënshkrimin — Ky nënshkrim po ashtu konfirmon se ofertuesi pranon shënimet me lartë dhe pajtohet që të obligohet me deklaratën e bërë këtu
Vërejtje: Ju lutem kini parasysh se të gjitha fushat duhet të jenë të plotësuara. Në rast se ndonjëra nga informatat mbetet e paplotësuar, oferta mund të diskualifikohet.

MODEL

KUJDES, TË PLOTËSOHEN TË GJITHA FUSHAT!!

NJOFTOHEN TË GJITHA PALËT E INTERESUARA SE DUKE FILLUAR NGA SHITJA E ASETEVE 49 E TUTJE APLIKOHEN RREGULLAT E REJA TË TENDERIT!

* Të gjithë ofertuesit potencial të cilët planifikojnë të dorëzojnë ofertën për asetet e përfshira në **Shitjen nr. 50 të Aseteve** janë të obligiuar që të përdorin dhe të plotësojnë në tërësi VETËM shtojcat në formatin e përfshirë në Rregullat e Tenderit në fuqi, përndryshe oferta e tyre mund të **DISKUALIFIKOHET!**

Formularët mund të shkarkohen në ueb faqen e AKP-së apo të tërhiqen në zyrën e marketingut në AKP.

LLOGARITË BANKARE PËR LIKUIDIM:

Tarifa për dorëzimin e ofertës prej 300 € (treqind Euro) duhet t'i paguhet AKP-së në BQK. Numri i llogarisë është: 1000510000000173
Depozita e ofertës duhet t'i paguhet AKP-së në BQK. Numri i llogarisë është: 1000510000000076

Për më shumë kontaktoni - Njësinë për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitorë
Rr. Agim Ramadani Nr. 23, (ish Rr. Ilir Konushevci Nr.8), 10 000 Prishtinë, Kosovë
tel: + 383 (0) 38 500 400 lok. 2005, ose 1152 / fax: + 383 (0) 38 248 076 e-mail: sales@pak-ks.org; www.pak-ks.org

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Shpallje Publike

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, Seksionin V Pikën 3 (c) të Rregullores së KEK-ut Sh.a. dhe nevojave të paraqitura për plotësimin e disa vendeve të lira të punës në Divizionet e KEK-ut, Divizioni i Burimeve Njerëzore, më 20.09.2019 publikon ofertën për pozitat e mëposhtme:

1. Teknik të makinerisë (30 Kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:
Bartësi i punës kryen punët e mirëmbajtjes mekanike dhe prodhimit ne Minierës Sipërfaqësore dhe/ose termocentrale, respektivisht: kaldaje, salle te makinave, objekte te jashtme dhe servise sipas kërkesave te lëshuara nga inxhinierët përgjegjës të mirëmbajtjes mekanike.
Respekton udhëzimet për mirëmbajte, te cilat janë përgatitur nga inxhinieri përgjegjës. Kryen preventivat e përgatitura nga inxhinieri përgjegjës me urdhrin e prijësit të ekipit dhe e informon atë për aktivitetet e kryera gjate preventives dhe ato te cilat kërkojnë ndaljen e pajisjeve.
I përgjigjet çdo kohe thirrjes për intervenim dhe te vazhdoj punën sipas nevoje. Zbaton te gjitha rregullat e sigurisë .Kryen edhe pune tjera me kërkesën e eproreve te tij

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet
Shkolla e Mesme e Makinerisë.
Të jetë i gatshëm të punoj vetëm dhe me ekip. Të dëshmoj aftësitë për të krijuar marrëdhënie të mira pune brenda dhe jashtë organizatës. Nivel të lartë të motivimit, Iniciativë, vendosmëria, intuita dhe vëmendje në detaje. Nivel të lartë të etikës profesionale.

2. Teknik të elektroteknikes (20 Kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Bartësi i punës kryen punët e mirëmbajtjes mekanike dhe prodhimit ne Minierës Sipërfaqësore dhe/ose ne termocentrale, respektivisht: kaldaje, salle te makinave, objekte te jashtme dhe servise sipas kërkesave te lëshuara nga inxhinierët përgjegjës të mirëmbajtjes se elektrike Respekton udhëzimet për mirëmbajte, te cilat janë përgatitur nga inxhinieri përgjegjës. Bartësi i vendit të punës është i obliguar të punoj sipas urdhëresave të cilat i shtron prijësi i ekipit dhe inxhinieri i kryerjes; përpunon dhe vizaton dokumentacionin e nevojshëm për meremetimin e makinave elektrike (motorët, transformatorët, dhe te tjera) pra te gjitha makinave elektrike. Përgjigjet për kualitetin dhe kuantitetin e punës. Kryen preventivat sipas urdhëresave teknologjike dhe i raporton prijësit të ekipit.
Është përgjegjës për punën normale të pajisjeve në sistem, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e veglave të punës.
Përgjigjet për mbajtjen e mjeteve mbrojtëse në punë sipas normave që i kërkon vendi i punës. Elektrotekniku duhet të jete i vetëdijshëm që gjatë kontrollës-preventives në sistem, sheh ose dëgjon ndonjë parregullsi të pajisjes duhet të intervenoj menjëherë për eliminimin e rrezikut.
Është i obliguar për raste të veçanta ti përgjigjet thirrjes të personelit të prodhimit për evitim të prishjeve,dhe nëse kërkohet të vazhdoj orarin e punës –vazhdimi bëhet sipas rregullores në fuqi

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet
Shkolla e Mesme Elektroteknike
Të jetë i gatshëm të punoj vetëm dhe me ekip. Të dëshmoj aftësitë për të krijuar marrëdhënie të mira pune brenda dhe jashtë organizatës. Nivel të lartë të motivimit, Iniciativë, vendosmëria,intuita dhe vëmendje në detaje. Nivel të lartë të etikës profesionale.

3. Manipulues te mekanizmit operativ (35 Kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:
Bartësi i vendit të punës është i obliguar të punoj sipas urdhëresave të cilat i shtron prijësi i ekipit dhe inxhinieri i kryerjes; përpunon dhe vizaton dokumentacionin e nevojshëm për meremetimin e makinave elektrike (motorët, frejte e tjera) pra te gjitha makinave. Përgjigjet për kualitetin dhe kuantitetin e punës Kryen preventivat sipas urdhëresave teknologjike dhe i raporton prijësit të ekipit. Është përgjegjës për punën normale të pajisjeve në sistem, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e veglave të punës.
Përgjigjet për mbajtjen e mjeteve mbrojtëse në punë sipas normave që i kërkon vendi i punës. Elektrotekniku duhet të jete i vetëdijshëm që gjatë kontrollës-preventives në sistem, sheh ose dëgjon ndonjë parregullsi të pajisjes duhet të intervenoj menjëherë për eliminimin e rrezikut
Është i obliguar për raste të veçanta ti përgjigjet thirrjes të personelit të prodhimit për evitim të prishjeve,dhe nëse kërkohet të vazhdoj orarin e punës –vazhdimi bëhet sipas rregullores në fuqi.

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet
Shkolla e Mesme.
Të jetë i gatshëm të punoj vetëm dhe me ekip. Të dëshmoj aftësitë për të krijuar marrëdhënie të mira pune brenda dhe jashtë organizatës. Nivel të lartë të motivimit, Iniciativë, vendosmëria,intuita dhe vëmendje në detaje. Nivel të lartë të etikës profesionale

4. Zjarrfikës (9 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Bartësi i vendit te punës bënë kryerjen e punëve për mbrojtjen nga zjarri në përputhje me ligjet dhe rregulloreve sipas dispozitat ligjore dhe akteve tjera nga kjo lëmi;Gjatë kohës së kujdestarisë, viziton objektin, lokalet, stabilimente pajimet dhe pajisjet e posaçërisht vendet të cilat mundet te vjen deri te shpërthimi i zjarrit, për të metat e vërejtura nga shkaktimi i zjarrit, menjëherë duhet të lajmëroj eprorin e vetë dhe në të njëjtën kohë të merr masat e duhura për pengimin e shkaqeve të pa dëshiruara;Gjatë vizitës së objektit të prodhimit dhe hapësirave tjera punuese bënë kontrollimin e pajisjeve kundër zjarrit mbi gjendjes e aftësisë, renditjen e tyre sipas planit dhe merr masa të duhura që çdo herë të jenë në gjendje gatishmërie;Të paralajmëroj punëtorët në objekt për nevojat e mirëmbajtjes dhe masave të parapara për mbrojtjen nga zjarri, në rast se i sheh ata që me punën e tyre bëjnë keqpërdorimin e mjeteve të MKZ, edhe krahas paralajmërimit, menjëherë duhet lajmëruar eprorin e tyre;Ti njoh dhe gjithherë ti mësoj të gjitha masat për mbrojtjen kundër zjarri sipas planit për mbrojtjen nga zjarri të objektit në Termocentral. Në momentin e pranimit detyrës të jetë i saktë, i rregullt, fizikisht dhe psiqikisht i aftë për kryerjen e punëve dhe detyrave;Që gjatë detyrës të mbaj uniformen e zjarrfikësit, ti ruaj, ti mirëmbaj dhe me qëllim ti përdor mjetet mbrojtëse personale me të cilat është i ngarkuar, si dhe në kryerjen e detyrave që bënë në objekt të sillet korrekt me punëtorët dhe me palët tjera;
Marrëdhëniet: Dispeçerit, Prijësit të etazhes, Inxhinieri i ndërrimit, Udhëheqësi i sektorit dhe Menaxherit të Departamentit
Autorizimet**:** Në raste emergjente kërkon kyçje – kyçjen e energjisë elektrike ujit. Kërkon deponimin, ngarkimin dhe zbarkimin e materieve të rrezikshme konform Rregulloreve në fuqi, Kërkon sigurimin e vendeve të rrezikshme nga shpërthimi i zjarrit si dhe largimin e burimeve të zjarrit.

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet dhe aftësitë e duhura:
Përgatitja e mesme shkollore**, Te jete nen moshën 30 vjeçare,(Ligji nr. 04/L-49 për zjarrfikës dhe Shpëtim**)
Te këtë aftësi psiko-fizike për të kryer aktivitetet e zjarrfikëse dhe shpëtimit

5. Manipulues të shiritave transportues (25 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:
Bartësi i vendit është përgjegjës për pastrimin e stacionit kthyes të shiritit në vazhdim dhe shiritit të vetë në gjatësi nga 50 m të dy shiritave transportues, pastrimin e koritës të tamburit shtrëngues dhe gjitha vendeve në konvejerë që pengojnë në procesin e prodhimit. Në rast rreziku për njerëzit ose për pajisjen ,menjëherë e bën shkyçjen e shiritit transportues. Gjatë kontrollimit të pajisjes vëren zhurmë jonormale në motor-reduktor, rrëshqitje të shiritit në tamburet ngasëse, ikje në një anë, grumbullim të materialit, mosfunksionim të fshesave, mosfunksionim normal të ruleve, dëmtim të shiritit, erë me shpejtësi të madhe ,menjëherë e ndërprenë punën dhe e lajmëron dispeçerin dhe prijësin
Marrëdhëniet: Dispeçerit, Prijësit të etazhës, Inxhinieri i ndërrimit, Udhëheqësi i sektorit dhe Menaxherit të Departamentit
Autorizimet: Në rast rreziku për njerëzit ose për pajisjen ,menjëherë e bën çkyçjen e shiritit transportues nëse konstaton zhurmë jonormale në motor-reduktor, rrëshqitje të shiritit nga tamburet ngasëse, ikje në një anë, grumbullim të materialit, mosfunksionim të fshisave, mosfunksionim normal të ruleve, dëmtim të shiritit, erë me shpejtësi të madhe .
Në rast rreziku për shiritin ose jetën e tij dhe te tjerëve duhet menjëherë ta ndalë shiritin me anë të një ndërprerësi (pullë-taster) të vendosur në distanca jo të mëdha në shirit transportues për ndalim të dhunshëm dhe për këtë ta njoftojë Dispeçerin dhe Prijësin e etazhes.

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet dhe aftësitë e duhura:
Shkolla e Mesme.
Të jetë i gatshëm të punoj vetëm dhe me ekip. Të dëshmoj aftësitë për të krijuar marrëdhënie të mira pune brenda dhe jashtë organizatës. Nivel të lartë të motivimit, Iniciativë, vendosmëria,intuita dhe vëmendje në detaje.Nivel të lartë të etikës profesionale

6. Inxhinier të makinerisë (3 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:
Bartësi i punës i përgjigjet Udhëheqësit të njësive gjegjëse ku ai caktohet dhe bashkëpunon me inxhinieret tjerë me përvojë me qëllim të ngritjes së njohurive profesionale të tij .Merr punët nga Udhëheqësi i Njësisë ku aktualisht është i përcaktuar dhe përpunon UP me ndërlikushmëri të lartë dhe të mesme tekniko teknologjike në bashkëpunim të ngushtë me inxhi përgjegjës.
Bashkëpunon edhe me kolegët e tjerë të Departamentit për realizimin me sukses të punëve që ka marr për sipër.
Përcjell dhe merr pjesë në hartimin e listave defektuese gjithnjë në bashkëpunim të ngushtë me inxhinierin përgjegjës.
Obligohet për zbatimin e metodave të avancuara tekniko teknologjike për aq sa lejojnë kushtet ekzistuese.
Punon dhe përpunon dokumentacionin teknik në formë elektronike (“Auto CAD).
Mban përgjegjësi për punët e kryera nga ana e tij.
Është i obliguar ta ruaj sekretin afarist.
Zbaton dhe respekton rregullat e mbrojtjes dhe sigurisë në punë sipas rregullave dhe ligjit në fuqi .
I kryen dhe i zbaton të gjitha detyrat dhe obligimet të tjera që i urdhërohen nga eprori i tij.

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet
Përgatitja superiore nga lëmia e Makinerisë, se paku niveli Bachelor
Njohuri të mira të gjuhës angleze dhe njohja e mirë e punës me kompjuter përparësi
Të jetë i gatshëm të punoj vetëm dhe me ekip. Të dëshmoj aftësitë për të krijuar marrëdhënie të mira pune brenda dhe jashtë organizatës. Nivel të lartë të motivimit, Iniciativë, vendosmëria, intuita dhe vëmendje në detaje.
Nivel të lartë të etikës profesionale.

7. Inxhinier të Elektroteknikes (6 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:
Bartësi i punës i përgjigjet kyçet në të gjitha punët inxhinierie të elektroteknikës që kryhen në Departament, me qëllim që të ti dalin në pah cilësitë e tij profesionale në bazë të së cilave më vonë do të emërohet në vend adekuat të punës .
Merr punët nga Udhëheqësi i Njësisë ku është i sistemuar dhe përpunon UP me ndërlikueshmëri të lartë dhe të mesme tekniko teknologjike në bashkëpunim të ngushtë me inxhinierin përgjegjës.
Bashkëpunon edhe me kolegët e tjerë të Departamentit për realizimin me sukses të punëve që ka marr për sipër.
Përcjell dhe merr pjesë në hartimin e listave defektuese gjithnjë në bashkëpunim të ngushtë me inxhinierin përgjegjës.
Obligohet për zbatimin e metodave të avancuara tekniko teknologjike për aq sa lejojnë kushtet ekzistuese.
Mban përgjegjësi për punët e kryera nga ana e tij.
Është i obliguar ta ruaj sekretin afarist.
Zbaton dhe respekton rregullat e mbrojtjes dhe sigurisë në punë sipas rregullave dhe ligjit në fuqi .
I kryen dhe i zbaton të gjitha detyrat dhe obligimet të tjera që i urdhërohen nga eprori i tij.

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet
Përgatitja superiore nga lëmia e Elektroteknikes, se paku niveli Bachelor
Njohuri të mira të gjuhës angleze dhe njohja e mirë e punës me kompjuter përparësi. Të jetë i gatshëm të punoj vetëm dhe me ekip. Të dëshmoj aftësitë për të krijuar marrëdhënie të mira pune brenda dhe jashtë organizatës. Nivel të lartë të motivimit, Iniciativë, vendosmëria, intuita dhe vëmendje në detaje.
Nivel të lartë të etikës profesionale.

8. Inxhinier i gjeologjisë (2 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i pozitës
Inxhinier përgjegjës i gjeologjisë në departamentin e djerrinës bën kordinimin dhe organizimin e punëve gjeologjike në të gjithë sektorët e departamentit të djerrinës.
Inxhinieri i gjeologjisë është i obliguar të bashkëpunoi me udhëheqësit e sektorëve në organizimin dhe kordinimin e eksploatimit të djerrinës si dhe palosjen e masave të djerrinës në terene stabile.
Jep urdhëresa dhe udhëzime gojore apo me shkrim në momente të duhura kur paraqitet problemi me stabilitetin e trollit,bën përcjelljen e qdo ndryshimi në teren ,krijimi i qarjeve,lëvizjen e masave,rrjedhjen e ujrave etj.
Është i obliguar të bëj dokumentimin gjeologjik për qdo fenomen që ndodhë në minier në mënyra të ndryshme si me hartë,me shkrim,fotografi etj.dhe njëherit këto të dhëna ti arkivoj.
Është përgjegjës për realizimin e detyrave gjeologjike që i përkasin minieres.
Është përgjegjës për kryerjen e punëve dhe detyrave sipas rregullave teknike duke zbatuar masat e mbrojtjes në bazë të ligjit dhe normave të gjeologjisë si dhe ligjit të mbrojtjes në punë për punëtoret ,paisjet në minier.
Autorizimet'Ka të drejtë të marr vendime për ndalimin e punës (prodhimit) në ato paisje ku nuk respektohen parametrat gjeologjik që mund të vie deri te rrezikimi i punëtorve-paisjes.Në kordinim me udhëheqësit e sektorëve,menaxherit dhe në bashkëpunim me departamentin e inxhinjeringut mund të kërkoi shpime plotësuese për qendrushmerin e terenit.Raportimet;Menaxherit të Departamentit të Djerrinës, udhëheqësve të sektorëve të xehetarisë,Vartësit e Drejtpërdrejtë**;**Menaxherit të Departamentit të Djerrinës, udhëheqësve të sektorëve të xehetarisë.
Kualifikimet
Përgatitja superiore nga lëmia e gjeologjisë, se paku niveli Bachelor
Te ketë aftësi organizative dhe mbikëqyrëse të shkëlqyer.

9. Inxhinier i xehetarisë (2 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i pozitës
Përgatit planet operative mujore, bënë zgjidhjen teknologjike me synim të arritjes së prodhimit dhe punon sipas marreveshjes dhe udhezimeve te Planifikuesit përgjegjës te Bardhit.
Bashkëpunon me subjektet e Minierës se Bardhit dhe Mirashit, Inxhinierët e Sektorëve tjerë te gjeologjisë, gjeomekanikes, hidrogjeologjisë, gjeodezisë, ndërtimtarisë si dhe të makinerisë dhe të elektros, me qellim të përgatitjes së planit operativ gjithëpërfshirës.
Bashkëpërgjegjës me planifikuesin kryesor për planifikimin e masave të sigurisë në harmoni me ligjin ne minera. Në bashkëpunim me shërbimet tjera bashkë planifikon riparimet vjetore dhe mujore te ekskavatorëve dhe paluesve te Bardhit si pajime kryesore xehetarë.
Raporton dhe informon për çdo ndryshim në terren te autoritetet kompetente siç është përcaktuar me anë të ligjeve dhe autorizimeve
Për kryerjen e detyrave që janë paraparë sipas nevojës mund të bashkëpunon me ekspertët, institute teknike të mbikëqyrjes, me shtëpi projektuese të pavarura etj.

Kualifikimet
Përgatitja superiore nga lëmia e xehetarisë, se paku niveli Bachelor
Te ketë aftësi organizative dhe mbikëqyrëse të shkëlqyer.

10. Administrator i zyrës (1 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i pozitës
Mbajtja e korrespodencës sipas programit dhe kërkesave te Drejtorit Operativ për Prodhim të DPQ-së: caktimi i takimeve zyrtare, pritja dhe përcjellja e palëve zyrtare, grupeve punuese, partnereve afarist për nevojat e DPQ-se;
Organizimi i takimeve te punës me departamente tjera te DPQ-se apo departamente te tjera te KEK-ut;
Pranon dhe informon Drejtorin me dokumentacionin, shkresat dhe materialet tjera te DPQ-se;
Përpunon, përzgjedhë dhe sistemon dokumentacionin sipas kërkesave te Drejtorit Operativ për Prodhim të DPQ-së;
Adreson dokumentacionin apo materialet qe dedikohen brenda dhe jashtë DPQ-se;
Mbanë evidencë te sistemuar për dokumentacion te krijuar për arkivim brenda apo jashtë DPQ-se;
Punon edhe punë të tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të drejtpërdrejt.
Kompetente për mbajtjen ne vazhdimësi te programit punues te Drejtorit Operativ për Prodhim të DPQ-së;
Kompetente për përpunim, seleksionim, sistemim dhe arkivim te dokumentacionit te zyrës se Drejtorit Operativ për Prodhim të DPQ-së;Kompetente për informim dhe raportim operativ ditor për ecurit e zyrës se Drejtorit.
Raportimet;Drejtpërdrejt i raporton Drejtorit Operativ për Prodhim të DPQ-së, ne mungese te tij i raporton edhe udhëheqësve te Sektorit apo te autorizuarit nga Drejtorit për zëvendësim.

Kualifikimet
Përgatitja superiore, se paku niveli Bachelor
Te ketë aftësi organizative dhe mbikëqyrëse të shkëlqyer.

Divizioni i Burimeve Njerëzore, fton të gjithë të interesuarit të aplikojnë për pozitat e publikuara

Për hollësitë e mëtutjeshme për pozitat e lartpërmendura shikoni në faqen e internetit të KEK-ut www.kek-energy.com.
Aplikacionet mund të merren në faqen tonë të internetit www.kek-energy.com dhe dërgohen në adresë elektronike ofertapune@kek-energy.com, pranë divizionit të Burimeve Njerëzore në KEK.

Format tjera te aplikimit nuk pranohen. Te gjitha aplikimet ne adresat elektronike te tjera nuk do te shqyrtohen.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Prishtinë, 20.09.2019
Data e aplikimit deri më 04.10.2019 ora 16:00
Divizioni i Burimeve Njerëzore

KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE D.D.
ad PRISHTINA

D P A
Departamenti për punë

Department for administrative works

Prishtinë me 20.09.2019 | Nr. 1600

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, KRU **„Prishtina“** sh.a. – Prishtinë, publikon:

K O N K U R S P U B L I K

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Kompani

1. **Dy (2) Inxhinier të Hidroteknikës,**
2. **Një(1) Operator për Impiantin e Trajtimit të Ujrave të Ndotura në Magurë- NJOU Lipjan,**
3. **Nëntë (9) Lexues-shpërndarës të faturave për zonën e veprimit të Kompanisë:**
   - **tre për zonën e Prishtinës,**
   - **dy për zonën e Fushë Kosovës,**
   - **një për zonën e Graqanicës,**
   - **një për zonen e Podujevës,**
   - **një për zonën e Lipjanit,**
   - **një për zonën e Obiliqit**
4. **Një (1) Teknik Laborant-dozator, për NJOU Drenas,**
5. **Tre (3) Ujëinstalues,**
6. **Tre (3) Kanalizator - Punëtor fizik,**

Kushtet :
Për kryerjen e këtyre punëve, përveç kushteve të përgjithshme, **k**andidatët duhet të kenë:

Për pikën 1: Kandidati duhet të këtë: - Fakultetin e Ndërtimtarisë - drejtimi hidroteknik, sistemi pesë vjeçar apo Master Shkencor (MSc), së paku 2 vite përvojë pune, njohja e gjuhës angleze është me përparësi.

Për piken 2: Kandidati duhet të ketë: - Pregaditjen universitare teknike, minimum Baçelor (BSc) drejtimi automatikë apo mekatronikë, -së paku 1 (një) vjet përvojë pune, njohuri në sisteme monitorimi, operimi, sisteme automatike SCAD.

Për piken 3: Kandidati duhet të ketë: - Përgatitjen e Mesme Shkollore; - së paku një vit përvojë pune; - aftësi të mira për komunikim me konsumator.
Preferohet të kenë: - njohuri në përdorimin e kompjuterit.

Për piken 4: Kandidati duhet të ketë: - Pregaditje te mesme teknike, drejtimi kimi - teknologji, - së paku 1 (një) vit përvojë punë, - njohuri në teknologjinë e trajtimit të ujit të pijës.

Për piken 5: Kandidati duhet të ketë: - Përgatitjen e mesme teknike, drejtimi instalues i ujit, - së paku 1 (një) vite përvojë punë, - njohuri në sistemet te instalimeve te ujit.

Për piken 6: Kandidati duhet të ketë: - Pregaditje te mesme teknike, së paku 1 vit përvojë punë, aftësi të mira fizike dhe shendetsore.

Paga mujore: Sipas Rregullores.

Kohëzgjatja e kontratës: Kohë të pacaktuar, me një periudhë të punës provuese prej 6 muajsh.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:
- diploma e përgaditjës shkollore;
- kopja e letërnjoftimit;
- çërtifikata e lindjes;
- vërtetimi i përvojës së punës;
- Cërtifikata që nuk është i dënuar dhe nën hetime më e re se 6 muaj;

Procedura për aplikim: Aplikacioni merret në Kompani ose në web-faqën e Kompanisë, të njëjtit i bashkëngjiten fotokopjet e dokumenteve personale dhe dokumentacioni tjetër të kërkuar sipas Konkursit dhe dërgohen në adresën KRU „Prishtina“ **sh.a.** në Prishtinë, Rr. „Hazir Shala“ nr.4., në zyrën nr. 44, më së voni deri me datën **07.10.2019** në ora **16.00**.
Vërejtje: Kërkesat e kandidatëve me dokumente të pakompletuara do të refuzohen ndersa ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim. Dokumentacioni i dorëzuar përmes postës pranohen brenda afatit 72 orë pas mbylljes se konkursit.

Kryeshefi Ekzekutiv

Rruga "Hazir Shala" nr.4, Prishtinë
Tel + 381 38 54 12 11, +381 38 55 10 10
Fax + 381 38 54 14 37
www.kur-prishtina.com
E-mail: mehdi.dervishi@kur-prishtina.com

NPT AGROKOVRAGA-FRUT

SHPALL TENDER

Për blerjen e kalibratorit per klasifikimin e pemve.

NUMRI KONTAKTUS:
044140588 Kovragë -Istog
n-azi.b@hotmail.com



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Hamit Fazliu i lindur më 29.08.1970 në Prekaz të Epërm të Skenderajt, shpallë të pavlefshëm diplomën e fakultetit Filologjikë dega: Letërsi dhe Gjuhë Shqipe të Universitetit të Prishtinës lëshuar në vitin 2004.

▶ Haris Salihu shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Leke Dukagjini" Prizren.

▶ Ajdoan Dinovci shpall te pavlefshme certifikatën SHMLR "11 Marsi" Prizren

▶ Aniva Huseini shpall te pavlefshme diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren

▶ Delifka Vecka shpall te pavlefshme diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren

▶ Erelira Gjemali shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX SHF "Mustafa Bakiu" Prizren

▶ Venhar Selmani shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

▶ Laureta Shala shpallë të pavlefshme dokumentet e shkollës së mesme "Lasgush Poradeci" Kijevë- Klinë drejtimi: Teknik Informatikë.

▶ N.T.P. "Diar Kids" - Burhan Kajtazi, shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me numër të biznesit: 80637594 dhe numër fiskal: 600337358

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi52 000€. Për info 044/672-439.

▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË PULE
gluten free
100% mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues

ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L